




MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME
INSPEKTORATI POLICOR I KOSOVËS
DEPARTAMENTI I INSPEKTIMEVE



RAPORT
I INSPEKTIMIT MBI MENAXHIMIN E RUAJTJES DHE KONTROLLIT
TE KUFIRIT DHE MIGRACIONIT

Nr. 6/2017

Prishtinë, 12 shkurt 2018

Informata të përgjithshme

Titulli	Raport i inspektimit mbi menaxhimin e ruajtjes dhe kontrollit të kufirit dhe migracionit
Data e përgatitjes	12 shkurt 2018
Përgatitur nga	Linda Ahmeti, inspektor (udhëheqës i ekipit) Kadri Keçmezi, inspektor, Mirsad Puqurica, inspektor
Mbikëqyrur nga	Ilir Idrizaj, mbikëqyrës i inspektimit Udhëheqës i Divizionit të Inspektimit dhe Raportimit
Mbështetur nga	Bujar Mustafa, Udhëheqës i Divizionit për Analizë, Planifikim dhe Cilësi
Dorëzuar nga	Bekim Pira, Udhëheqës i Departamentit të Inspektimit
Miratuar nga	Miradije Kelmendi, Ushtruese e detyrës së Kryeshefit Ekzekutiv Inspektorati Policor i Kosovës
Data e miratimit	12 shkurt 2018



1. Përmbledhja ekzekutive

- 1.1. Informacion i përgjithshëm mbi rezultatet e inspektimit.....(4-5)
- 1.2. Informacion i përgjithshëm mbi zbatimin e rekomandimeve.....(5-5)

2. Hyrje

- 2.1 Arsyet e inicimit të inspektimit.....(6-6)
- 2.2 Qëllimi i inspektimit.....(6-6)
- 2.3 Objekti i inspektimit.....(6-6)
- 2.4 Subjekti i inspektimit.....(6-6)
- 2.5 Objektivat e inspektimit.....(7-7)
- 2.6 Rëndësia e inspektimit.....(7-7)
- 2.7 Metodologjia e inspektimit.....(7-8)
- 2.8 Periudha e kryerjes së inspektimit.....(8-8)
- 2.9 Periudha e mbulimit të inspektimit.....(8-8)
- 2.10 Drejtimet e inspektimit.....(8-8)
- 2.11 Kriteret e vlerësimit.....(9-9)
- 2.12 Pengesat dhe kufizimet në arritjen e objektivave.....(9-9)

3. Përshkrimi i objektit, gjetjet dhe rekomandimet

- 3.1 Organizimi, funksionimi e kapacitetet në menaxhimin e kufirit..(10-16)
- 3.2 Menaxhimi i Integruar i Kufirit.....(17-19)
- 3.3 Aktivitetet patrulluese dhe të kontrollit kufitar.....(19-23)
- 3.4 Performanca policore në hetimin e krimit ndër-kufitar.....(23-24)
- 3.5 Evidencat policore dhe sistemi elektronik i menaxhimit kufitar.....(25-25)
- 3.6 Kushtet teknike dhe të sigurisë.....(26-27)

4. Plani për përmbushjen e rekomandimeve

- 4.1 Plani i veprimit për realizimin e rekomandimeve.....(28-30)

Shtojca

1. Përmbledhja ekzekutive

1.1. Informacion i përgjithshëm mbi rezultatet e inspektimit

1.1.1. Policia Kufitare e përfaqësuar nga Departamenti i Kufirit të Policisë së Kosovës (PK), konform mandatit ligjor ka kompetencë në kryerjen e detyrave në kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufirit shtetëror. Departamenti i Kufirit vlerësohet se ka realizuar organizimin e saj të brendshëm struktural konform infrastrukturës ligjore në fuqi. Struktura aktuale organizative është rrjedhojë e kërkesave dhe nevojave për të përmbushur misionin e Departamentit në kontrollin efikas të kufirit, mbikëqyrjen e vijës kufitare, kontrollin e migrimit dhe parandalimin e luftimit të krimin ndërkufitar. Vlerësohet se Policia Kufitare ka në dispozicion tërë infrastrukturën e nevojshme ligjore, mbi të cilën bazohet kryerja e detyrave operacionale. Veprimet që realizohen, synohen të ndërmerren bazuar në praktikatat që janë në frymën e standardeve të Schengenit. Janë nxjerrë aktet nënligjore që mbështesin kryerjen e aktiviteteve kufitare, që konsiderohet se janë të harmonizuara me legjislacionin themelor. Inspektimi vë në pah nevojën e stabilizimit të strukturës me burimet njerëzore siç përcaktohet me Listën e Autorizuar të Personelit (LAP). Për shkak të ndjeshmërisë së natyrës së punës, duhet ngritur vigjilencën në vetëdijesimin e personelit që të jetë i rezistueshëm ndaj përfshirjes në keqpërdorime të detyrës zyrtare, duke aplikuar metoda të lëvizjes së tij brenda strukturës drejt zbatimit të Strategjisë Anti Korrupsion. Ka ngecie në përmbushjen e agjendës trajnuese për personelin duke mbetur prapa plotësimin të kushteve për ri-certifikim dhe trajnime të brendshme. Duhet shqyrtuar politikatat mbi freskimin e personelit sipas kriterit të moshës dhe stimulimit të diversitetit gjinor. Ka ecje para në avancimin e pajisjeve në përdorim nga personeli i stacioneve policore që lidhen me kontrollin e personave, automjeteve e dokumenteve. Janë identifikuar nevojat për pajisje me kondicioner dhe radiolidhje. Me gjithë përparimin e bërë lidhur me pajisjet për punë, ka nevojë për kompletimin e infrastrukturës teknike në disa stacione. Ka një paraqitje të mirë në mbajtjen e evidencave dhe të kujdesit ndaj vulave. Gjendja e automjeteve konsiderohet jo e kënaqshme, duke ndikuar në rënien e fuqisë aktive të tyre dhe kjo mund të jetë ndikuese në efikasitetin e kontrollit të vijës kufitare.

1.1.2. Policia Kufitare është përfshirë në Menaxhimin e Integruar të Kufirit (MIK) me një numër akterësh vendorë e ndërkombëtarë, andaj bazuar në Planin e Veprimit të Strategjisë për Menaxhimin e Integruar të Kufirit për periudhën 2013-2018, bashkëpunimi në mes tyre është i shtrirë brenda autoritetit, në kuadër të MIK-ut dhe në rrafshin ndërkombëtar. Takimet e përbashkëta të realizuar me akterët e tre niveleve të bashkëpunimit kanë shënuar rënie. Operacionet e kryera nga njësitë brenda policore kanë shënuar ngritje, kurse ato të përbashkëta me akterët e MIK-ut kanë shënuar rënie. Vija kufitare që kontrollon Policia Kufitare përfshinë gjithsej 743.5 km¹, prej të cilës, vendi ynë me Malin e Zi kufizohet në gjatësi prej 78 km vijë kufitare, me Shqipërinë me 116.3 km, me Serbinë me 381.6 km dhe me Maqedoninë me 167.6 km. Me të gjitha këto vende, në përjashtim të Serbisë janë në fuqi marrëveshjet mbi patrullimet e përbashkëta përgjatë vijës kufitare, në drejtim të kontrollit efikas kufitar, menaxhimit të migrimit dhe luftimit të krimin ndërkufitar. Është shënuar shtim i numrit të patrullimeve të përbashkëta me policitë e vendeve fqinje.

1.1.3. Në drejtim të ngritjes së efikasitetit të mbikëqyrjes kufitare përgjatë vijës së gjelbër, duhet të rishikohen politikatat mbi pranim-dorëzimin e detyrave të patrullave kufitare në kuadër të stacioneve policore të mbikëqyrjes së kufirit (SPMK). Rishikimi i tillë duhet të marrë parasysh kapacitetet

¹ Agjencia e Statistikave të Kosoves, *Vjetari statistikor i Republikës së Kosovës*, 2017.

teknike të këtyre stacioneve. Është e rrugës që Policia e Kufirit të analizojë dhe identifikojë faktorët që kanë ndikuar në rënien e numrit të patrullimeve me automjete dhe atyre në këmbë nga SPMK-të. Drejtoritë Rajonale Policore Kufitare (DRPK) dhe SPMK-të duhet të analizojnë metodologjitë e përdorura në aktivitete patrulluese dhe numrin e tyre në nivel të SPMK-së dhe ndërrimeve. Kontrolli i personave dhe automjeteve ka shënuar ngritje, siç ka shënuar ngritje edhe numri i kontrolleve të vijës së dytë. Ngarkesën më të madhe për stacion/polic vazhdojnë ta kenë Vërmica dhe Hani i Elezit. Sa i përket kontrollit të migrimit, ka shënuar ngritje numri i gjobave të shqiptuara ndaj shkelësve të rregullave mbi lëvizjen e shtetasve të huaj. Ngritje kanë shënuar edhe aktivitetet e Drejtorisë për Migrim e të Huaj, që lidhen me inspektimet e bizneseve, institucioneve dhe lokacioneve të dyshimta.

1.1.4. IPK-ja nuk ka vërejtur se janë shkelur kompetencat mbi nivelet e autoriteteve që kanë trajtuar rastet e ngritura penale. IPK-ja ka kryer një verifikim mbi mënyrën se si janë proceduar dhe trajtuar rastet e hapura penale nga aktiviteti kriminal në zonat ndërkuftare dhe ka vlerësuar se duhet kushtuar kujdes marrjes së gjurmëve të gishtërinjëve nga të dyshuarit dhe nxjerrjes së raporteve për Prokurorin e Shtetit për rastet kur ka dyshime të arsyeshme se janë kryer vepra penale. Raportet tregojnë se ka rënie të numrit të veprave penale që ndërlidhen me krimin ndërkuftar. Nga të gjitha rastet e ngritura, rënie kanë shënuar kontrabanda me migrant, kalimi i paautorizuar i kufirit dhe posedimi i paligjshëm i armëve, kurse kontrabanda me narkotikë, kontrabanda me mallra dhe kontrabanda me kafshë kanë shënuar ngritje. Trend rënës ka edhe numri i arrestimeve për vepra të ndryshme kriminale.

1.1.5. IPK-ja ka kontrolluar një numër evidencash dhe ka vlerësuar se ato mbahen në përputhje me PSO-në për evidencat. Me gjithë faktin se Sistemi i Menaxhimit Kufitar (SMK) është funksional në të gjitha PKK-të, ai ballafaqohet me disa probleme që e përcjellin si rrjedhojë e rënies së rrjetit dhe rrymës. Ri-freskimi i të dhënave në Stop-Listë paraqet një problematikë, duke i sjellë probleme kontrollit kufitar, për shkak se ato nuk janë të azhuruara apo të ri-freskuara sa duhet. Kjo shtron nevojën që të mobilizohen njësitë kompetente në eliminimin e këtyre dobësive.

1.1.6. Sa i përket kushteve të punës në objekte policore, vërehet se disa prej tyre ballafaqohen me hapësira të pa mjaftueshme për punë. Nuk është parë se është krijuar një standard mbi kushtet që duhet të përmbushen nga çdo stacion apo objekt kufitar, duke përcaktuar hapësirat e veçanta për sallat e takimeve, dhomat e intervistave, dhomat e dëshmimeve, etj. Disa stacione policore kryejnë aktivitete në kontejnerë, pa hapësira të mjaftueshme pune. Nuk janë vërejtur dobësi sa i përket mirëmbajtjes së objekteve. Është ecur para me instalimin e sistemit të monitorimit me kamera në objekte. Duhet bërë ende lëvizje drejt përmirësimit të kushteve, përfshirë vendosjen e hidranteve, klimatizimit, kontrollimit të pajisjeve kundër zjarrit, alarmit, etj.

1.2. Informacion i përgjithshëm mbi zbatimin e rekomandimeve

1.2.1. Nga inspektimi i kryer ka rezultuar se nga 12 rekomandime të lëna në inspektimin e kaluar (inspektimi nr. 08/2012), tetë (8) prej tyre janë realizuar plotësisht, dy (2) janë përmbushur në masën më të madhe (përgjithësisht), një (1) është realizuar pjesërisht dhe një (1) nuk është vlerësuar për shkak se kanë ndryshuar kushtet dhe rrethanat nën të cilat është zhvilluar Policia dhe strukturuar togjet patrulluese, që tani quhen SPMK (*për më tepër referoju tabelës në shtojcën 1*).

2. Hyrje

2.1. Arsyet e inicimit të inspektimit

2.1.1. Në bazë të Ligjit nr. 03/L-231, IPK-ja ka mandat ligjor që të kryejë inspektime në PK, për të vlerësuar mënyrën e kryerjes së detyrave policore. Ky aktivitet ndihmon dhe mbështetë Policinë për të siguruar një shërbim profesional, demokratik e të përgjegjshëm. Plani Vjetor i Inspektimeve të Rregullta i Departamentit të Inspektimit të IPK-së, për vitin 2017 ka përfshirë kryerjen e inspektimeve në disa fusha të menaxhimit, përfshirë edhe menaxhimin e ruajtjes dhe kontrollit të kufirit e migracionit. Inspektimi i kësaj fushe të menaxhimit paraqet fushë me interes për IPK-në me qëllim të vlerësimit nëse PK ka ndërtuar një strukturë organizative funksionale, me kapacitete të mjaftueshme teknike dhe njerëzore për menaxhimin e kufirit e migracionit, se ka nxjerrë bazën ligjore e strategjike të nevojshme për të kontrolluar ruajtjen e kufirit, për të lehtësuar qarkullimin e lirë të njerëzve dhe mallrave, për të luftuar krimin ndërkufitar dhe për të realizuar detyra tjera që dalin nga koncepti i MIK-ut. Është e nevojshme që profesionalizmi, përkushtimi, transparencja dhe llogaridhënia të jenë evidente dhe të qëndrueshme në menaxhimin sa më efektiv të ruajtjes dhe kontrollit të kufirit e migracionit. Duke kuptuar rëndësinë e kësaj fushe, Kryeshefi Ekzekutiv i IPK-së më 4 tetor 2017, mbi bazën e Programit të miratuar të punës inspektuese të po të njëjtës datë, ka inicuar një inspektim për të vlerësuar performancën policore në këtë fushë të menaxhimit.

2.2. Qëllimi i inspektimit

2.2.1. Qëllimi i këtij inspektimi është:

- Që të përcaktojë nëse ligjet, rregulloret dhe parimet e procedurat policore përkatëse zbatohen si duhet dhe janë të përshtatshme për të arritur qëllimet,
- Që të përcaktojë nëse burimet policore shfrytëzohen në mënyrë efektive, efikase dhe se janë të përshtatshme për të arritur qëllimet dhe objektivat e saja,
- Që të jepet opinion objektiv mbi çështjet që lidhen me fushën e menaxhimit të kufirit,
- Që të parandalojë shkeljet eventuale që mund të kryhen gjatë punës policore në fushën përkatëse,
- Që të identifikojë mangësitë apo dobësitë dhe të rekomandojë masa ligjore e organizative për funksionimin më të mirë të PK-së.

2.3. Objekti i inspektimit

2.3.1. Në këtë inspektim është vlerësuar kryerja e detyrave policore në fushën e menaxhimit të ruajtjes dhe kontrollit të kufirit e migracionit.

2.4. Subjekti i inspektimit

2.4.1. Inspektimi është përqendruar kryesisht në Departamentin për Kufi, divizionet, drejtoritë rajonale policore kufitare dhe stacionet policore kufitare në pikat e kalimit kufitar (PKK).

2.5. Objektivat e inspektimit

2.5.1. Objektivat që synon t'i arrijë ky inspektim janë:

- Vlerësimi i kapaciteteve organizative, ligjore, njerëzore dhe teknike në menaxhimin e kufirit,
- Vlerësimi i kryerjes së detyrave në kontrollet kufitare, karshi detyrave të përcaktuara me ligj,
- Vlerësimi i aktiviteteve patrulluese në mbikëqyrjen e kufirit (kufiri i gjelbër dhe i kaltër),
- Vlerësimi i implementimit të detyrave që dalin nga koncepti i MIK-ut,
- Vlerësimi i indikatorëve të performancës në luftimin efikas të krimit ndër-kufitar,
- Vlerësimi i mirëmbajtjes së bazës së të dhënave në funksion të strukturës kufitare.

2.6. Rëndësia e inspektimit

2.6.1. Inspektimi në këtë fushë të menaxhimit luan rol të rëndësishëm në:

- Ushtrimin e kontrollit adekuat menaxhial dhe operativ, për të siguruar shkallë më të lartë të punës profesionale, llogaridhënies, transparencës dhe besueshmërisë,
- Ngritjen e përgjegjësisë së punonjësve në respektimin me përpikëri të procedurave për patrullime dhe kontrolle kufitare, drejt sigurimit të lëvizjes së lirë të njerëzve e mallrave
- Ngritjen e vetëdijes policore për të kontribuar me më përkushtim në parandalimin dhe zvogëlimin e akteve të pa ligjshme në zonat kufitare,
- Ngritjen e besimit të qytetarëve mbi përkushtimin policor në menaxhimin e kufirit dhe lëvizjen e lirë të njerëzve dhe mallrave.

2.7. Metodologjia e inspektimit

2.7.1. Gjatë inspektimit:

- a) Janë zhvilluar intervista dhe takime me punonjës si në vijim:
 - Udhëheqësin e Departamentit të Kufirit,
 - Udhëheqësin e Divizionit të Kontrollit dhe Mbikëqyrjes së Kufirit,
 - Udhëheqësin e Divizionit për Menaxhimin e Integruar të Kufirit,
 - Drejtorët e DRPK-ve,
 - Komandantin e Stacionit Policor 'Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës',
 - Komandantët e SPK-ve të kategorisë A,
 - Komandantët e SPMK-ve.
- b) Janë kryer vëzhgime, këqyrje apo kontrollime, si në vijim:
 - Janë inspektuar kushtet e punës që ndërlidhen me ruajtjen dhe kontrollin e kufirit,
 - Është inspektuar procedura e kontrollit kufitar të vijës së parë dhe të dytë në PKK,
 - Janë inspektuar evidencat e sistemit elektronik dhe programet e kontrollit kufitar,
 - Janë kontrolluar kërkesat për azil të bëra në pikë kalimet kufitare,
 - Janë kontrolluar dokumentet mbi mënyrën e lëshimit të vizave në PKK,
 - Janë kontrolluar dhe verifikuar evidencat që mbahen nga personeli në PKK.
- c) Janë plotësuar formularët e inspektimit të përgatitur nga Departamenti i Inspektimit:

- Lidhur me pajisjet në vijën e parë dhe të dytë të kontrollit kufitar në PKK,
 - Lidhur me vulat hyrëse/dalëse dhe llojet e evidencave në PKK,
 - Lidhur me mbajtjen dhe funksionimin e Sistemit të Menaxhimit Kufitar,
 - Lidhur me kushtet teknike, të sigurisë dhe ato higjienike në ndërtesat policore.
- d) Janë siguruar dëshmitë, si në vijim.
- Planet vjetore të Departamentit të Kufirit,
 - Raportet vjetore të Departamentit të Kufirit,
 - Lista e Autorizuar e Personelit për Departamentin e Kufirit,
 - Raportet vjetore të Drejtorive Rajonale Policisë Kufitare,
 - Raportet periodike mbi parandalimin, zbulimin dhe hetimin e krimit ndër-kufitar,
 - Kopjet e përzgjedhura të dosjeve hetimore për dy vitet e fundit,
 - Dëshmi mbi trajnimet, zhvillimin dhe avancimin e personelit përmes trajnimeve konkrete dhe të nevojshme që lidhen me policinë kufitare,
 - Dëshmi mbi inspektimet e kryera nga menaxhmenti mbi zbatimin e standardeve të kontrollit kufitar, mbikëqyrjes së kufirit, hetimit të krimit,
 - Dëshmi mbi numrin e vizave të lëshuara gjatë dy viteve të fundit, sipas PKK-ve,
 - Formularët standard të profilimit në vijën e parë dhe të dytë të kontrollit kufitar,
 - Dëshmi mbi pajisjet e nevojshme për policinë kufitare,
 - Oraret e patrullimit për muajin e fundit,
 - Dëshmi mbi ndërtimet e përbashkëta të PKK-ve me shtetet fqinje.

2.8. Periudha e kryerjes së inspektimit

2.8.1. Bazuar në Programin e punës inspektuese, inspektimi ka filluar me datë 09.10.2017 dhe ka përfunduar më datë 24.10.2017.

2.9. Periudha e mbulimit të inspektimit

2.9.1. Inspektimi është përqendruar në vlerësimin e kryerjes së detyrave policore gjatë periudhave kalendarike janar-dhjetor 2015 dhe janar-dhjetor 2016. Veç tjerash, inspektimi është fokusuar edhe në gjendjen aktuale në disa pika të inspektimit.

2.10. Drejtimit e inspektimit

2.10.1. Për përmbushjen e objektivave, inspektimi është fokusuar në këto drejtime kryesore:

- Organizimi, funksionimi dhe kapacitetet policore në menaxhimin e kufirit,
- Menaxhimi i Integruar i Kufirit,
- Aktivitetet patrulluese dhe të kontrollit kufitar,
- Performanca policore në hetimin e krimit ndër-kufitar,
- Evidencat policore dhe sistemi elektronik i menaxhimit kufitar,
- Kushtet teknike dhe të sigurisë për punë në menaxhimin e kufirit.

2.11. Kriteret (standardet) e vlerësimit

2.11.1. Dokumentet në vijim janë baza, në të cilën është mbështetur puna e inspektorëve, gjatë vlerësimit të kryerjes së detyrave në departamentet, drejtoritë, stacionet apo njësitë policore:

- Ligji nr. 04/L-076 për Policinë,
- Ligji për Kontrollin dhe Mbikëqyrjen e Kufirit Shtetëror,
- Ligji për Azil,
- Ligji për të Huaj,
- Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës,
- Udhëzimet Administrative,
- Procedurat Standarde të Operimit,
- Planet emergjente,
- Plani Veprues i Strategjisë Kombëtare për Menaxhimin e Integruar të Kufirit (2013/18),
- Plani Zhvillimor Strategjik 2016-2020,
- Dokumentet tjera të rëndësishme që rregullojnë fushën e menaxhimit kufitar.

2.12. Pengesat dhe kufizimet në arritjen e objektivave

2.12.1. IPK-ja vlerëson se gjatë punës në terren dhe pasqyrimin të gjetjeve në raportin e zgjeruar të inspektimit, nuk ka hasur në ndonjë vështirësi që do të ndikonte në përmbushjen me sukses të objektivave të vëna me Programin e punës inspektuese.

3. Përshkrimi i objektit, të gjeturat dhe rekomandimet

3.1. Organizimi, funksionimi dhe kapacitetet policore në menaxhimin e kufirit

3.1.1. Kur flitet për ruajtjen dhe kontrollin e kufirit në kuadër të këtij inspektimi, kemi të bëjmë me kontrollin kufitar² dhe mbikëqyrjen kufitare³ të rregulluar me Ligjin nr. 04/L-072 për Kontrollin dhe Mbikëqyrjen e Kufirit Shtetëror. Ky Ligj, ka përcaktuar që Ministria e Punëve të Brendshme (MPB) është organi, i cili ka kompetencë mbi kontrollin kufitar, kurse punët që kanë të bëjnë me kontrollin kufitar i kryen Policia Kufitare në kuadër të Policisë së Republikës së Kosovës. Departamenti për Kufi është pjesë e strukturës policore me detyra të përcaktuara në kontrollin e mbikëqyrjen e kufirit, kontrollin e hyrjes, qëndrimit dhe lëvizjes së të huajve, parandalimin dhe luftimin e krimit ndër kufitar. Departamenti i Kufirit sipas strukturës aktuale⁴ është organizuar në nivel qendror dhe lokal. Përbëhet nga Divizioni i Kontrollit dhe Mbikëqyrjes së Kufirit, në kuadër të të cilit janë të sistemuara DRPK-të (Lindja, Veriu, Perëndimi dhe Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës), si dhe Divizioni i Menaxhimit të Integruar të Kufirit, në kuadër të të cilit është sistemuar Drejtoria e Operativës dhe Drejtoria për Migrim dhe të Huaj. Në kuadër të Drejtorisë së Operativës funksionon Sektori për Planifikim, Sektori i Hetimeve dhe Njësia për Analizë të Riskut, Intelegjencë dhe Administrim të Dhënave. Në kuadër të Drejtorisë për Migrim dhe të Huaj funksionon Sektori për Kontrollin e të Huajve dhe Sektori për Deportime. DRPK-të kanë Sektorët për Kontroll e Mbikëqyrje të Kufirit (SPK/SPMK), Sektorët e Operativës së Kufirit (Qendra Operative, Njësia e Analizës së Riskut, Intelegjencës dhe Administrimit të të Dhënave, Njësia e Hetimeve, Njësia për Migrim e të Huaj, Njësia K9) dhe Sektorët për Resurse (Njësia për Burime Njerëzore dhe Njësia për Mbështetje).

3.1.2. Janë gjithsej 16 Pikë Kalime Kufitare (Stacione Policore Kufitare) të kategorizuara në A, B dhe C, kurse tre (3) të tjera janë në proces për t'u hapur (Kapi, Izvor dhe Stanqiq⁵. SPK-të në PKK të kategorisë A operojnë me Sektorët e Operativës, Sektorët e Hetimeve dhe Zyrat për Resurse. Janë të hapura 24 orë në ditë dhe shërbejnë për qarkullim të njerëzve, mjeteve dhe mallrave. Kontrollat kryhen në vijën e parë dhe në vijën e dytë nëse vlerësohet e nevojshme. Në këto PKK vazhdimisht janë prezent Policia Kufitare, Dogana e Kosovës (DK), Agjencia e Ushqimit dhe Veterinës (AUV). SPK-të në PKK të kategorisë B operojnë me Sektorët e Operativës, Sektorët e Hetimeve dhe Zyrat për Resurse. Këto janë të hapura 24 orë në ditë dhe shërbejnë për qarkullim të personave, mjeteve dhe mallrave me sasi të kufizuar. Në këto PKK është prezent Policia, 24 orë në ditë. SPK-të në PKK të kategorisë C janë të përkohshme dhe janë të hapura për intervale të caktuara kohore. Shërbejnë vetëm për qarkullim të personave dhe hapen me marrëveshje bilaterale me shtetet fqinje, me qëllim: të realizimit të aktiviteteve kulturore, sportive, religjioze, shkencore, profesionale e turistike; reagimit në fatkeqësi natyrore dhe situata emergjente; zbatimit të marrëveshjeve ndërkufitare; dhe realizimit të aktiviteteve bujqësore, blegtorale ose aktiviteteve të tjera ekonomike.

² Sipas Ligjit nr. 04/L-072 për kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufirit shtetëror, kontrolli kufitar përkufizohet si kontroll i kryer në pikat e kalimit kufitar për të siguruar që personat, mallrat dhe mjetet e tyre të transportit janë të autorizuar të hyjnë në territorin e Republikës së Kosovës apo të lëshojnë Republikën e Kosovës.

³ Sipas Ligjit nr. 04/L-072 për kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufirit shtetëror, mbikëqyrja kufitare përkufizohet mbikëqyrja e kufirit shtetëror ndërmjet pikave të kalimit kufitar dhe mbikëqyrja e pikave të kalimit kufitar jashtë orarit të caktuar të punës me qëllim që të pengohet anashkalimi, përkatësisht shmangia e kontrollit kufitar.

⁴ Drejtoria e Përgjithshme e Policisë, *Struktura Organizative e Policisë*, 24.05.2012, Prishtinë.

⁵ Drejtoria e Përgjithshme e Policisë, *Udhëzimi Administrativ nr. 07/2010 për kategorizimin e PKK-ve*.

3.1.3. Në kuadër të DRPK-ve operojnë 12 SPMK. Këto operojnë me Sektorin e Operativës me katër (4) ekipe patrulluese dhe Zyrën për Resurse që menaxhohen nga komandantët e SPMK-ve. Kufiri shtetëror ruhet nga patrullat policore kufitare 24 orë në ditë. Ekipe patrulluese punojnë me orar 12 orësh. Aktivitetet e patrullimit që ndërmerren nga SPMK-të në parandalimin dhe luftimin e krimit ndërkufitar në vijën e gjelbërt dhe të kaltërt përfshijnë patrullimet e pavarura, patrullimet me autoritetet e përfshira në MIK dhe patrullimet e përbashkëta / të sinkronizuara me shtetet fqinje dhe KFOR-in. Brenda këtyre aktiviteteteve kufitare, ekipe patrulluese praktikojnë patrullime në këmbë, patrullime me mjete (automjet, barka, sajë motorik, motoçikleta), patrullime të kombinuar, vëzhgime të fshehta, prita policore dhe pika kontrolli.

3.1.4. Për kryerjen e detyrave që lidhen me kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufirit, Departamenti i Kufirit mbështetet në Ligjin e Policisë, Ligjin për Kontrollin dhe Mbikëqyrjen e Kufirit Shtetëror, Ligjin për të Huaj, Ligjin për Azil dhe në Udhëzimet Administrative, si akte nënligjore që burojnë nga këto ligje. Me këto akte janë përcaktuar detyrat dhe përgjegjësitë për çdo njësi organizative. Janë përpiluar dhe miratuar PSO-të përkatëse që detajojnë detyrat, veprimet dhe procedurat për çdo aktivitet të Policisë Kufitare. Rregulloret e brendshme janë harmonizuar me legjislacionin në fuqi. IPK-ja ka vërejtur se faqja zyrtare përditësohet me çdo ndryshim të ligjeve, akteve nënligjore, rregulloreve të brendshme si dhe PSO-ve. Personeli i Departamentit të Kufirit është i njoftuar me ndryshimet e tilla. IPK-ja çmon angazhimet në ndërmarrjen e hapave konkret drejt harmonizimit të akteve me të ulëta me legjislacionin bazik në fushën e menaxhimit të kufirit.

3.1.5. IPK-ja e konsideron Policinë si organizatë dinamike sa i përket ndryshimeve strukturore dhe lëvizjeve të burimeve njerëzore. Nevoja për një shpërndarje më adekuate të burimeve njerëzore në kuadër të Departamentit të Kufirit vërehet edhe pas këtij inspektimi të kryer. Marrë përgjithësisht gjendjen kuantitative me burime njerëzore, vlerësohet se ka një shpërputhje të numrit të aprovuar me Listën e Aprovuar të Personelit (LAP) të datës 05.12.2016, me gjendjen aktuale. Duke iu referuar të dhënave të Departamentit të Kufirit mbi kapacitetet njerëzore të fund vitit 2016, Departamenti në tërë strukturën e saj ka pasur të angazhuar 1.343 punonjës, derisa LAP ka përcaktuar numrin prej 1.317⁶ punonjësve policorë. Tejkallim të numrit të lejuar kemi tek kategoria e të punësuarve me gradë rreshter dhe tek personeli i pa graduar policor, derisa mungesa kemi tek të punësuarit me gradë major dhe kapiten. Është verifikuar plotësimi i vendeve të punës dhe pozitave, me fokus të veçantë në DRPK dhe SPK në PKK të kategorise A, si stacione me angazhime më të dukshme, në krahasim me ato të kategorizuar si B e C. Vërehen vendosje të punonjësve në pozita menaxheriale, me gjithë faktin se të tillët ushtrojnë detyrat me grada më të ulëta. Janë identifikuar raste të ushtrimit të detyrave në pozita udhëheqëse nga punonjës me grada më të larta se që kërkohen për pozitat e tilla. Raste të mbi dhe nënvendosjes në pozita menaxheriale nga punonjës me grada jo adekuate vërehen gati në tërë strukturën e kufirit. Departamenti i Kufirit duhet të angazhohet me Divizionin e Burimeve Njerëzore në stabilizimin e strukturës sa i përket numrit të punonjësve, duke sistemuar dhe vendosur numër të punonjësve varësisht nga kapacitetet që lejon LAP. Kjo ri-vendosje duhet të marrë parasysh nevojat për vendosjen e të graduarve në pozita menaxheriale siç e kërkon LAP.

⁶ Drejtoria e Përgjithshme e Policisë, *Lista e Personelit të Autorizuar në Policinë e Kosovës (Departamenti i Kufirit)* 5 dhjetor 2016, Prishtinë.

Tabela nr. 1. Të dhëna përmblledhëse mbi kapacitetet e burimeve njerëzore (dhjetor 2016)									
Departamenti i Kufirit	Kapacitetet e burimeve njerëzore sipas gradave								
	Kol	N/kol	Maj	Kap	Tog	Rresh	Pol	SHC	Gjiths.
Burimet aktuale njerëzore	3	4	5	16	45	182	1.044	44	1.343
Burimet e lejuara me LAP	3	4	7	18	44	170	1.027	44	1.317
Ndryshimi	0	0	-2	-2	+1	+12	+17	0	+26

Rekomandimi nr. 1
<i>IPK-ja u rekomandon Departamentit të Kufirit që në bashkëpunim me Divizionin e Burimeve Njerëzore të bëjnë një analizë të nevojave për burimet njerëzore dhe të ndërmarrin hapa konkret drejt vendosjes së tyre varësisht nga numri dhe gradat, të përcaktuar me Listën e Autorizuar të Personelit.</i>

3.1.6. Policia e Kufirit konsiderohet një ndarje organizative brenda strukturës policore me burime të konsiderueshme njerëzore dhe të shpërndara në divizione, drejtori, stacione, sektorë dhe njësi. Të menaxhuarit me këto burime kërkon përkushtim e profesionalizëm, meqë organizata është dinamike dhe atë e përcjellin ndryshime strukturore dhe lëvizje të personelit. Lëvizjet e personelit shpeshherë shkaktojnë mungesa dhe hendikepe që vështirësojnë mirë funksionimin. Në këtë drejtim, organizata synon të orientojë mirë funksionimin, i cili sfidohet nga mungesa e personelit, nevojat për transfere, paraqitjet e disiplinës së brendshme, etj. Organizata duhet të jetë e kujdesshme që personeli i saj të jetë rezistent ndaj dukurive negative që mund ta prekin atë. Në Polici është marrë parasysh lëvizja e personelit bazuar në Strategjinë Anti Korrupsion, edhe pse në numër nuk vlerësohet se ka qenë edhe mjaft evidente. Nuk është vërejtur se një Strategji e tillë ka prekur mjaftueshëm edhe nivelet e larta udhëheqëse. Është e nevojshme që edhe pozitat e larta menaxhuese të drejtorive, stacioneve dhe sektorëve të jenë objekt për lëvizje dhe kjo i kontribuon integritetit organizativ. Në drejtim të ngritjes së nivelit të kujdesit ndaj vartësve, në mënyrë që të tregojnë integritet të lartë moral dhe profesional, brenda Departamentit janë aplikuar metoda, përmes të cilave personelit i është bërë të ditur për nevojën e të qenurit rezistent ndaj dukurive negative dhe për pasojat që mund t'i bartë institucioni dhe individit. Janë mbajtur takime formale me qëllim të vetëdijësimit mbi pasojat dhe dëmet që aktet e korrupsionit i sjellin shoqërisë, zhvillimit dhe cilësisë së jetës. Janë evidentuar raste të lëvizjeve të personelit si rezultat i vëzhgimeve, inspektimeve, kontakteve me qytetarë, tërheqjes së vëmendjes në takime dhe gjetjes së dëshmimeve që inkriminojnë zyrtarët në aktivitet kriminal, etj. Viti 2017 shquhet me ngritjen e numrit të paraqitjeve së disiplinës së brendshme. Ky vit shënon edhe ngritje të numrit të transfereve administrative, dalës dhe atyre hyrëse, në krahasim me vitin paraprak. Është nevojshme që për ngritjen e cilësisë së shërbimit, në të ardhmen të ketë mobilizim të shtuar në freskimin e burimeve dhe lëvizjen e kapaciteteve ekzistuese, duke marrë parasysh faktorët ndikues (koha e gjatë në shërbim, pushimet, trajnimet, mungesat dhe obligimet).

Tabela nr. 2. Të dhëna mbi aktivitetet e burimeve njerëzore dhe disiplinën (2015-2017)			
Aktiviteti	Vitet		
	2015	2016	2017
Transferet administrative	16	3	6
Transfere dalëse	26	20	25
Transfere hyrëse	26	17	32
Paraqitjet e disiplinës së brendshme	73	41	84

Rekomandimi nr. 2

IPK-ja i rekomandon Departamentit të Kufirit që të analizojë gjendjen aktuale dhe të shqyrtojë fuqizimin e mekanizmit për lëvizjen e personelit, përfshirë edhe atë të graduar në kuadër të strukturës policore të kufirit, duke marrë parasysh faktorët ndikues, por gjithnjë duke vlerësuar se kjo mund t'i shërbejë shëndetit të organizatës dhe ngritjes së efikasitetit brenda shërbimit.

3.1.7. Plani Zhvillimor Strategjik (2016-2020) ka vënë objektiv strategjik, ngritjen dhe zhvillimin e kapaciteteve të burimeve njerëzore. Plani ka përcaktuar organizimin e trajnimeve të përbashkëta të avancuara, ndërinstucionale dhe ndërkufitare, në fushën e kontrollit dhe mbikëqyrjes së kufirit, me qëllim të parandalimit dhe luftimit të krimit ndërkufitar. Fushë interesimi për IPK-në kanë qenë edhe trajnimet e brendshme, si dhe ato ri-certifikuese. Vlerësohet se ka ngecie në organizimin dhe vijimin e trajnimeve të brendshme që përcaktohen me Rregulloren për Personel dhe Administratë, sipas së cilës, drejtoritë rajonale duhet të kujdesen që secili zyrtar policor brenda një viti të mbajë së paku 40 orë trajnim. Situatë e njejtë qëndron edhe me trajnimet e ri-certifikimit që organizohen nga AKSP, që sipas rregullit, të gjithë zyrtarët policorë janë të obliguar që brenda periudhës kohore për çdo 12 deri në 18 muaj ta vijojnë një trajnim të tillë. Këto ngecie vërehen në tërë strukturën e kufirit edhe lidhur me trajnimin për armët e gjata AK-47. Vlerësohet se trajnimin lidhur me BMS-në e kanë të kryer pjesë e konsideruar e zyrtarëve të përfshirë në përdorimin e Sistemit në fjalë. Të shumtë janë mbështetësit e PK-së në ofrimin dhe përkrahjen me trajnime në fushën e kufirit. IPK çmon rolin e këtyre organizatave ndërkombëtare në ofrimin e përkrahjes konkrete, drejt fuqizimit të kapaciteteve të burimeve njerëzore konform standardeve më të larta për menaxhim kufitar. Janë organizuar edhe trajnime tjera brenda dhe jashtë shtetit, përfshirë ato të specializuara, të avancuara, seminare, vizita studimore, këshillime, takime profesionale dhe shkencore. IPK është interesuar të vlerësojë mënyrën e nominimit të punonjësve policorë për pjesëmarrje në trajnimet e tilla dhe ka vërejtur se ka përsëritje të disa personave, qoftë me apo pa grada, të nominuar më shpesh për këto programe. Kjo vërehet edhe nga shqetësimet e disa drejtuesve të Policisë Kufitare të deklaruar për trajtim jo të barabartë në nominimin e personelit policor, nga personat përgjegjës. Kështu që, Departamenti i Kufirit dhe Divizioni i Trajnimeve duhet të jenë më të kujdesshëm në nominimin e punonjësve adekuat, në mënyrë që trajnimi t'i shërbej natyrës së punës për të cilën organizohen trajnimet apo vizitat, seminarët dhe takimet e tilla. Kjo kërkon kujdes të shtuar në përmbushjen e të gjitha kriterëve të përcaktuara për nominimin e punonjësve policorë për një trajnim të caktuar.

Rekomandimi nr. 3

IPK-ja i rekomandon Departamentit të Kufirit që në të ardhmen të ndërmarrë veprimet e nevojshme që konform Rregullores për Personel dhe Administratë, si dhe Procedurës Standarde të Operimit për rregullat dhe procedurat e trajnimeve dhe studimeve në Fakultetin e Sigurisë Publike, të përfshijë personelin policor në trajnimet e nevojshme, përfshirë ato të brendshme, trajnimet ri-certifikuese dhe trajnimet tjera të nevojshme për Policinë Kufitare.

3.1.8. Vërehet një pjesë e personelit që i takon një kategorie punonjësish të shtyrë në moshë, me çka paraqet një tregues se mund të vështirësojë kryerjen me sukses të punëve zyrtare, duke ndikuar edhe në rënien e efikasitetit. Janë evidentuar një numër kërkesash për sanimin e gjendjes aktuale me burime njerëzore, me qëllim që kapacitetet e reja të mund të sigurohen përmes konkurseve të hapura publike. Problematike është edhe çështja e konkurseve të brendshme në kuadër të strukturës së Policisë Kufitare, meqë nuk ka interesim për të lëvizur brenda strukturës, pasi sipas vlerësimeve

të drejtuesve, lëvizjet në pozita vakante nuk përmirësojnë gjendjen materiale të tyre. Problematikë tjetër është edhe mungesa e personelit të gjinisë femërore në stacione. Angazhimi me punë në kuadër të SPK-ve nuk zgjon interesim për punonjëset e gjinisë femërore, për shkak të problemeve me transport, ndërrimeve e orareve të pa përshtatshme të punës dhe mungesës së stimulimit për këto pozita, pasi vlerësojnë se mund të marrin paga të njejta në kuadër të ndonjë njësie tjetër policore. Duhet të gjenden strategji apo të projektohen politika për përmirësimin e kësaj gjendjeje, në mënyrë që përmes stimulimit të diversitetit gjinor, vendet e tilla të punës të jenë sa më atraktive dhe më mirë të vlerësuara materialisht. Nevojitet prezenca e punonjësve të gjinisë femërore për situatat kur është e nevojshme kryerja e procedurave të kontrollimit të personave të gjinisë së njejtë. Mungesa e personelit të gjinisë femërore në këto raste vështirëson kryerjen e detyrave të kësaj natyre në përputhje me rregullat dhe procedurat e kërkuara.

Tabela nr. 3. Të dhëna përmblledhëse mbi moshën mesatare të personelit (dhjetor 2017)							
Indikatorët	Kapacitetet e burimeve njerëzore sipas gradave						
	Kol	N/kol	Maj	Kap	Tog	Rresh	Pol
Numri i punonjësve	3	4	3	17	45	169	1.044
Mosha mesatare	58	48	58	50	46	47	47

3.1.9. Sipas PSO-së mbi Standardet e Kontrollit Kufitar, kontrolli kufitar në trafikun hekurudhor duhet të kryhet në PKK-në për zonën e caktuar të trafikut hekurudhor. Meqenëse ky lloj kontrolli kërkon angazhim të shtuar të burimeve njerëzore për shkak të natyrës dhe gjerësisë së kontrollit, vlerësohet që Departamenti për Kufi duhet të analizojë gjendjen me kapacitetet aktuale të burimeve njerëzore, meqë kjo mbetet edhe shqetësim i udhëheqësve të stacioneve të Hanit të Elezit dhe atij të Jarinjës. Shtimi i kapaciteteve do të mund të siguronte që zyrtarët policorë kufitar të mund të inspektojnë të gjitha hapësirat brenda trenave. Terreni i largët, kontrolli i thellë, kushtet e punës, herë pas here po e vështirësojnë punën në kryerjen e detyrave.

3.1.10. Plani Zhvillimor Strategjik 2016-2020 ka vënë objektiv strategjik, avancimin e aktiviteteve në fushën e kontrollit dhe mbikëqyrjes dhe lidhur me këtë ka përcaktuar aktivitetet në pajisjen e SPK-ve dhe SPMK-ve me teknologji të avancuar për kontrollin e kufirit. Në Policinë Kufitare këto pajisje janë në përputhje me standardet evropiane. Furnizimi me pajisje që përkojnë me Policinë Kufitare vlerësohet të jetë i kënaqshëm, duke e bërë Departamentin që të jetë ndër më të pajisurit me pajisje të avancuara, krahasuar me policitë kufitare të vendeve të rajonit. Zyrtarët kufitarë në SPK dhe SPMK bëjnë përpjekje të zbatojnë praktikën më të mira të Schengenit, përfshirë këtu bashkëpunimin në të gjitha nivelet me të gjitha autoritetet, shfrytëzimin e analizës së riskut, dhe përdorimin e pajisjeve për kontrollë dhe mbikëqyrje. Kjo ndikon në zbatimin e kontrollit efektiv kufitar të dokumentacionit të personave dhe automjeteve, zvogëlimin e kohës së pritjes, si dhe përdorimin e bazave të të dhënave të kontrollit kufitar. SPK-të janë të furnizuara mirë me pajisje adekuate për punë. Lidhur me evidencat është në përdorim Sistemi i Menaxhimit Kufitar i quajtur 'BMS' (Border Managing System), si Sistem unik me shtrirje në tërë territorin e Kosovës. Janë inspektuar edhe SPMK-të, të cilat janë mirë të pajisura me pajisje të avancuara që hyjnë në punë për sigurimin dhe kontrollin e vijës së gjelbër kufitare. Me qëllim të efikasitetit, operacionalitetit, racionalizimit të kryerjes së detyrave, aktiviteteve me interes të përbashkët dhe në fusha të tjera të bashkëpunimit, autoritetet e përfshira në MIK në mënyrë të ndërsjellë ofrojnë ekspertizë të veçantë dhe asistencë teknike. Zyrtarët policorë kanë pajisjet e mjaftueshme për kryerjen e kontrollit

kufitar dhe përdorimi i tyre është në nivelin e kënaqshëm sepse në kuadër të çdo drejtorie apo stacioni është instaluar një sistem i një trajnimi të trajnerëve që merret në konsideratë, me të cilën shumë nga këta trajnerë pastaj ia përcjellin njohuritë e nevojshme zyrtarëve policorë që kanë të bëjnë me punën praktike në terren.

3.1.11. Ndihet nevoja për vendosjen e klimave në kabinat e kontrollit, në zyret e kujdestarisë ku janë të vendosur numër i madh i aparaturave, të cilat lirojnë temperaturë të lartë dhe në zyrën e kontrollit të vijës së dytë të dokumenteve për shkak të ruajtjes së aparateve nga temperaturat e larta (në këtë zyre është e vendosur pajisja VSC 8000, si pajisje e kushtueshme). Vërehet në përgjithësi se në të gjitha DRPK-të kanë mungesë të radiolidhjeve, por edhe një numër i atyre që janë në dispozicion teknikisht nuk funksionojnë me çka shkaktojnë edhe probleme në komunikim. Lidhur me posedimin e pajisjeve të nevojshme në vijën e parë të kontrollit, IPK-ja ka konsultuar PSO-në mbi Standardet e Kontrollit Kufitar (DDK-05/307/15) dhe ka verifikuar Listen e pajisjeve duke e krahasuar me gjendjen aktuale të tyre në SPK. Është një disponueshmëri e kënaqshme me pajisjet e kontrollit të vijës së parë, me disa mungesa në disa SPK. Në Merdare e Jarinjë mungon terminali portabël kur është e nevojshme, në Jarinjë mungon detektori për radioaktivitet. Lidhur me pajisjet për vijën e dytë të kontrollit, në Vërmicë kanë tre (3) copë fibroskop jo funksional, në Dhe të Bardhë dhe në Merdare nuk e kanë çantën e paisjeve CT30, në Dhe të Bardhë nuk kanë fibroskop.

Rekomandimi nr. 4

IPK-ja i rekomandon Departamentit të Kufirit, që varësisht nga mundësitë buxhetore për avancimin e infrastrukturës teknike në fushën e menaxhimit të ruajtjes dhe kontrollit të kufirit, të pajisë të gjitha stacionet policore kufitare me pajisjet e nevojshme të kontrollit kufitar, siç përcaktohet me PSO-në mbi Standardet e Kontrollit Kufitar.

3.1.12. Sistemi SMK vazhdon të ketë pengesa të kohë pas kohshme si pasojë e ndërprerjes së rrjetit apo rrymës dhe në këto intervale, personeli kufitar kryen evidentimet e nevojshme në librin fizik. Drejtoria e TIK-ut është kompetente dhe ka të drejtë, për arsye të sigurisë së sistemit, që në çdo kohë të bëjë kontroll dhe mirëmbajtje të rrjetit. Problemet me Stop Listë⁷ janë evidente kohë pas kohe sepse nuk ri-freskohen të dhënat sa duhet. Vlerësohet se ekziston një koordinim jo i duhur me gjykatat. Kjo bën që të haset në probleme me qytetarët e rastit, ngase vie deri tek ndalimi i tyre gjatë kontrollit kufitar, deri sa bëhet verifikimi adekuat. Është vlerësuar se kjo i humb kohë edhe Policisë edhe qytetarëve. Në të ardhmen, Policia duhet të ketë një qasje më aktive, më efikase dhe më bashkëpunuese me Gjykatat, mbi procesimin e të dhënave të personave të dyshimtë në evidencat policore.

Rekomandimi nr. 5

IPK-ja i rekomandon Departamentit të Kufirit që të sanojë problemet teknike që krijojnë pengesa në kryerjen e kontrolleve dhe regjistrimeve të nevojshme në Sistemin e Menaxhimit Kufitar (SMK) dhe po ashtu të ndërmarrë hapat e nevojshëm në bashkëpunim me DTIK-un dhe njësitë tjera policore në përditësimin e informatave në Stop-Listë në kuadër të SMK-së.

⁷ Stop Lista është një bazë e të dhënave në kuadër të SMK-së që përmban të dhëna për ndalim të personave të dyshimtë, të kërkuar apo të zhdukur, të dhëna për automjete të raportuara të vjedhura, dokumente të humbura/të vjedhura.

3.1.13. Lidhur me evidencat e vulave hyrëse dhe dalëse, PSO mbi mbajtjen e evidencave në PKK përcakton rregullat për ruajtjen dhe sigurinë e përdorimit të vulave. Sipas PSO-së, komandanti i PKK, vulat e pranuar i vendos në kasafortë në zyrën e shefit të ndërrimit dhe autorizon me shkrim shefat e ndërrimit për fillimin e përdorimit të tyre. Sipas kësaj procedure, jashtë orarit të punës dhe kur vula nuk përdoret, ajo ruhet në kasafortën e veçantë e cila duhet të jetë në zyrën e mbikëqyrësit të ndërrimit dhe ajo mundësisht të jetë e tejdukshme. IPK-ja ka vërejtur se të gjitha SPK-të e inspektuara i kanë kasafortat e veçanta, të cilat janë në zyrën e mbikëqyrësit të ndërrimit, por këto kasaforta janë metalike, të mbyllura me çelës dhe çelësin e mbanë shefi i ndërrimit. Vetëm në SPK Jarinje, kasafortë nuk ka fare dhe vulat ruhen në zyrën e shefave të ndërrimit. Të gjitha SPK-të e inspektuara dhe ANP-ja, përdorimin e vulave e bëjnë në bazë të formularit të pranimit-dorëzimit të shefave të ndërrimit, por nuk kanë autorizim të veçantë nga Komandanti, secili mbikëqyrës është i ngarkuar me vula hyrëse / dalëse, secili polic ka formën standarde për pranimit-dorëzim të vulës. Është e nevojshme që konform PSO-së, komandantët të autorizojnë me shkrim shefat e ndërrimit për përdorimin e vulave dhe ruajtjen e tyre, si dhe në SPK Jarinje të sigurohet kasafortë metalike apo edhe të tejdukshme me qëllim të ruajtjes së vulave dhe mbajtjes së evidencave.

3.1.14. Policia Kufitare është e pajisur me automjete zyrtare të tipeve të ndryshme, duke marrë parasysh edhe kërkesat që dalin për përdorim të tyre në terrenet e vështira për qarkullim. Një numër automjete nuk janë në gjendje të mirë teknike, gjë që shkakton pengesë për kryerjen e detyrave. Automjetet vazhdojnë të mbesin shqetësime për menaxhmentin, që ndikon direkt në efikasitetin e kryerjes së detyrave policore në ruajtjen dhe kontrollin e kufirit. Raportet e tre viteve të fundit të Departamentit të Kufirit pasqyrojnë një rënie të fuqisë aktive të automjeteve të disponueshme në kuadër të të gjithë strukturës së kufirit. Nga viti 2015, kur numri i automjeteve aktive ka qenë 151, në vitin 2016, ky numër ka rënë në 136, duke arritur në vitin e fundit, në 129 sosh, e që paraqet nivelin më kritik të disponueshmërisë së automjeteve aktive në vitet e fundit. Ekziston numër i konsideruar i automjeteve që janë pasive për shkak të vjetërsisë dhe kilometrave të kaluara, por edhe gjendjes teknike jo të mirë të tyre. Shkaktarët e kësaj gjendjeje janë të shumtë, por vazhdimi i saj ndikon negativisht në përmbushjen e detyrave. Nevojitet një mobilizim i Departamentit të Shërbimeve Mbështetëse dhe Departamentit të Kufirit në trajtimin e kësaj çështjeje, duke synuar përmirësimin e gjendjes dhe ngritjen e kapaciteteve aktive të automjeteve të disponueshme. Duhet ndërmarrë hapa konkret në aftësimin e automjeteve që mund të funksionojnë edhe në të ardhmen, të largohen automjetet që kanë plotësuar kriteret për tjetërsim dhe të merret parasysh mundësia e shpërndarjes së automjeteve shtesë për Departamentin.

Rekomandim nr. 6

IPK-ja u rekomandon Drejtorit të Departamentit të Shërbimeve Mbështetëse dhe Drejtorit të Departamentit të Kufirit, që të ndërmarrin veprimet e nevojshme në sanimin e gjendjes së rëndë me automjete, në mënyrë që të eliminohen situatat që mund të ndikojnë në rënien e efektivitetit dhe të performancës së njësisve policore kufitare.

3.2. Menaxhimi i Integruar i Kufirit⁸

3.2.1. Duke iu përmbajtur konceptit për MIK-un, Departamenti i Kufirit për arritjen e objektivit për kufi të hapur, të kontrolluar dhe të sigurt, ka bashkëpunim me shumë akterë të përcaktuar në shkëmbimin e analizave të riskut, analizave vjetore dhe raporteve të vlerësimit të kërcënimeve nga krimi i organizuar dhe krimet e rënda. Plani i Veprimit të Strategjisë Kombëtare të Menaxhimit të Integruar të Kufirit për tre nivelet e bashkëpunimit ka përcaktuar objektiva dhe veprime konkrete drej sigurimit të kufinjve të hapur, të kontrolluar dhe të sigurt. Policia Kufitare është përfshirë në tre nivelet e bashkëpunimit në kuadër të MIK-ut. Në nivel brenda autoritetit është përfshirë në shkëmbimin e analizave të riskut, vlerësimeve strategjike të DIA-së dhe raporteve mbi vlerësimet e kërcënimeve nga krimi i organizuar dhe krimet e rënda. Brenda Policisë janë organizuar takime në nivel operacional, por që krahasuar tre vitet e fundit, viti 2015 del të jetë viti me numrin më të madh të takimeve brenda Policisë. Menaxhimi i operacioneve në kufi kërkon vlerësime dhe analiza mbi situatën në kufi, informata mbi treguesit e rrezikut dhe kërcënimet e mundshme për sigurinë e kufirit dhe vendit. Në këtë drejtim, nga autoritetet e përfshira në MIK organizohen dhe realizohen takime të rregullta periodike dhe nga Raporti Vjetor i Departamentit të Kufirit, del se Policia ka marrë pjesë në takime të tilla, por që numri i tyre është në rënie nga viti në vit. Viti 2015 del të jetë viti me numrin më të madh të cilat është përfaqësuar PK. Në rrafshin ndërkombëtar janë realizuar takime me zyrtarë të shteteve fqinje me qëllim të ngritjes së efikasitetit në fushën e shkëmbimit të informacionit, kontrollit kufitar, hetimeve të përbashkëta, etj, por që numri i tyre gjithashtu është në rënie nga viti në vit. Edhe në këtë rrafsh, viti 2015 del të jetë viti me numrin më të madh të takimeve me shtetet fqinje, ku është përfaqësuar Policia. IPK-ja inkurajon Policinë Kufitare në ndërmarrjen e veprimeve drejt përmbushjes së objektivave strategjike, por duhet të analizojë arsyet e rënies së trendit të takimeve në tre nivelet e bashkëpunimit.

Niveli i bashkëpunimit	2015	2016	2017
Brenda Policisë	160	121	124
Autoritetet e MIK-ut	129	120	87
Bashkëpunimi ndërkombëtar	381	241	207

3.2.2. Meqenëse koncepti i MIK-ut nënkupton krijimin, zhvillimin dhe thellimin e bashkëpunimit me akterët e përfshirë në tre nivele, IPK-ja është interesuar të vlerësojë arritjet, duke krahasuar objektivat dhe veprimet e përcaktuara me Planin e Veprimit të Strategjisë Kombëtare të Republikës së Kosovës për Menaxhimin e Integruar të Kufirit (2013-2018). Kur i referohemi bashkëpunimit brenda autoritetit, është vendosur objektiv për avancimin e bashkëpunimit në mes departamenteve të PK-së. Në përmbushjen e objektivit të vënë, është ndarë detyrë për Policinë, që të organizohen operacione të përbashkëta në ngritjen e efikasitetit në ruajtjen dhe kontrollin e kufirit shtetëror. IPK ka siguruar numrin e operacioneve të organizuara brenda autoritetit, si tregues i performancës policore në përmbushjen e objektivit të vënë. Policia Kufitare ka planifikuar, organizuar e realizuar operacione ku janë përfshirë drejtori dhe njësi në kuadër të saj. Në vitin 2017 janë realizuar gjithsej 301 operacione, që paraqet numrin më të madh të operacioneve të realizuara në tre vitet e fundit. Ky numër është për 6% më i lartë se në vitin 2015 dhe për 17% më i lartë se në vitin 2016. ‘Veriu’

⁸ Menaxhimi i Integruar i Kufirit nënkupton bashkëpunimin dhe organizimin kombëtar dhe ndërkombëtar ndërmjet të gjitha autoriteteve të përfshira në sigurinë e kufirit dhe lehtësimin e tregtisë për të vendosur menaxhim kufitar efektiv, efikas dhe të bashkërenduar në mënyrë që të arrihet objektivit për kufi të hapur por të kontrolluar dhe të sigurt.

shquhet me numrin më të madh të operacioneve të realizuar përgjatë tre viteve. Viti 2016 ka rezultuar me numrin më të vogël të operacioneve të realizuar në tre vitet e fundit. Inkurajohen autoritetet e Departamentit të Kufirit të vazhdojnë me trendin në ngritje të numrit të operacioneve, varësisht nga nevojat dhe planet operationale.

3.2.3. Kur i referohemi bashkëpunimit ndërmjet autoriteteve të përfshira në MIK, është vendosur objektivi për ‘ngritjen e kapaciteteve bashkëpunuese dhe bashkërenduese të autoriteteve kufitare në fushën e shkëmbimit të informacioneve, inteligjencës së përbashkët kriminale, analizave të rrezikut dhe parandalimit të veprave të kundërligjshme’. Në përbushjen e objektivit të vënë është ndarë detyrë për disa akterë, ku është përfshirë edhe Policia Kufitare, që të hartohen plane, krijohen ekipe dhe të realizohen operacione të përbashkëta për parandalimin e veprave të kundërligjshme. IPK ka siguruar numrin e operacioneve të përbashkëta që ka realizuar Policia Kufitare me akterët e përfshirë, si tregues i performancës në përbushjen e objektivit të vënë. Në vitin 2017 janë realizuar 104 operacione të përbashkëta me autoritetet e MIK-ut, që paraqet numrin më të ulët të operacioneve të realizuara në tre vitet e fundit. Ky numër është për 38% më i ulët se në vitin 2015 dhe për 44% më i ulët se në vitin 2016. NJSP K-9 shquhet me numrin më të madh të pjesëmarrjes në operacione të përbashkëta të realizuar përgjatë tre viteve. Viti 2016 ka rezultuar me numrin më të madh të operacioneve të përbashkëta të realizuara në tre vitet e fundit. Inkurajohen autoritetet e Departamentit të Kufirit që të ngrisin angazhimet drejt ngritjes së trendit të operacioneve të përbashkëta për të parandaluar veprat e kundërligjshme.

Tabela nr. 5 - Të dhëna mbi operacionet e organizuara brenda autoritetit dhe në kuadër të MIK							
Drejtoria Njësia	Operacione brenda autoritetit			Drejtoria Njësia	Operacione të përbashkëta me autoritetet e MIK-ut		
	2015	2016	2017		2015	2016	2017
Drejtoria e Operativës	27	19	31	Dogana (FAST)	37	47	15
Drejt. për Mig. & Huaj	0	3	3	NJSP K-9	102	103	58
Njësia e Hetimeve	14	3	4	AUV	1	0	0
ANP	19	13	3	AKP	0	1	0
DRPK Lindja	53	75	57	KFOR	6	4	9
DRPK Perëndimi	72	57	82	MI	3	0	0
DRPK Veriu	99	88	121	SP/Njësi tjera	20	24	22
Gjithsej	284	258	301		169	187	104

3.2.4. Fillimisht duhet cekur se kontrolli dhe mbikëqyrja e vijës së gjelbër dhe të kaltër në kufirin me Shqipërinë, Malin e Zi dhe Maqedoninë është në kompetencë të Policisë Kufitare të Republikës së Kosovës. Në rrafshin e bashkëpunimit ndërkombëtar, Plani i Veprimit të Strategjisë Kombëtare për Menaxhimin e Integruar të Kufirit ka përcaktuar përbushjen e objektivit për shtimin e numrit të patrullimeve të përbashkëta dhe atyre të sinkronizuara me autoritetet relevante të shteteve tjera. Plani Zhvillimor Strategjik lidhur me zbatimin e kontrollit dhe mbikëqyrjes së kufirit në përputhje me standardet e Schengenit, ka përcaktuar kryerjen e patrullimeve të përbashkëta me autoritetet e përfshira në MIK dhe me policitë kufitare të shteteve fqinje. Ekzistojnë dhe realizohen marrëveshje për patrullime të përbashkëta me Shqipërinë, Maqedoninë dhe Malin e Zi. Për kontrollin dhe mbikëqyrjen e vijës kufitare janë arritë marrëveshje me shtetet fqinje për realizimin e patrullimeve të përbashkëta, për të parandaluar aktivitetet e jashtëligjshme dhe për reagim adekuat në situata të jashtëzakonshme. Veprime të tilla nuk janë arritur me Republikën e Serbisë. Përgjithësisht vërehet

shtim i numrit të patrullimeve të përbashkëta me policitë e vendeve fqinje dhe këto shifra kanë shënuar ngritje të vazhdueshme nga viti në vit. Viti 2017 konsiderohet viti me numrin më të madh të patrullimeve të përbashkëta duke arritur në shifrën prej 438, që është për 33% më i lartë se në vitin 2015 dhe për 3% më i lartë se në vitin 2016. Numri më i madh i patrullimeve të përbashkëta është arritur me Policinë Kufitare të Shtetit Shqiptar. Situata më ndryshe qëndron me patrullimet e sinkronizuara, ku vërehet ngecie e dukshme. Në vitin 2016 nuk është evidentuar asnjë patrullim i vetëm, përderisa viti 2017 njihet si vit i funksionalizimit të këtyre patrullimeve me tre shtetet fqinje edhe pse numri i tyre është shumë modest.

Tabela nr. 6 - Të dhëna përmblledhëse mbi patrullimet e përbashkëta me policitë e shteteve fqinje

Lloji i patrullimit	Shqipëri			Maqedoni			Mali i Zi			Gjithsej		
	2015	2016	2017	2015	2016	2017	2015	2016	2017	2015	2016	2017
Të përbashkëta	161	201	230	101	118	111	67	106	97	329	425	438
Të sinkronizuara	0	0	6	241	0	4	0	0	5	241	0	15

3.3. Aktivitetet patrulluese dhe të kontrollit kufitar

3.3.1. Gjatë inspektimit të aktiviteteve patrulluese përgjatë vijës së gjelbër, IPK-ja në tre vizitat e kryera gjate periudhave të ndryshme kohore ka hasur në tre patrulla kufitare të SPMK-ve, në kuadër të tre DRPK-ve. Janë inspektuar patrulla kufitare e SPMK-Gjilan (03.11.2017), patrulla kufitare e SPMK-Vitimiricë (01.11.2017) dhe patrulla kufitare e SPMK-Keqekollë (02.11.2017). Ekipet patrulluese kanë qenë duke respektuar orarin, të pajisura me uniformë dhe paisje personale të përcaktuar me rregullat në fuqi. Përbërjet e ekipeve patrulluese dhe detyrat në ekip ishin të ndara në harmoni me PSO-në mbi standardet e mbikëqyrjes së kufirit. Patrulla kufitare e SPMK-Gjilan ishte e pajisur me vetëm një armë të gjatë, që vlerësohet se është në kundërshtim me PSO-në. Kjo patrullë ka pasur radio për komunikim në automjet dhe 2 nga 4 zyrtarët patrullues nuk kanë pasur pajisje të tillë. Automjeti i patrullës kufitare të SPMK-Vitimiricë ka pasur radio për komunikim por jo edhe zyrtarët policorë. Patrulla kufitare e SPMK-Keqekollë, radio për komunikim kishte pasur në automjet por në gjendje teknike jofunksionale, kurse 2 nga 4 zyrtarët patrullues nuk kishin pasur radio për komunikim. Pengesën për ndalimin e automjeteve (iriq) nuk e kishte pasur në automjet patrulla policore e SPMK-Keqekollë. Sa i përket pajisjeve të tjera të parapara me PSO, ekipet patrulluese të inspektuara kanë qenë të pajisura. Automjetet me të cilat operonin ekipet patrulluese ishin në gjendje jo të mirë teknike, me dëmtime e goma të vjetëruara. Patrulla kufitare e SPMK-Gjilan kishte automjetin me fren dore jo funksional, bagazh të bllokuar, me probleme të marshit dhe goma të amortizuara.

3.3.2. IPK-ja ka analizuar politikat dhe metodat e pranim-dorëzimit të detyrave dhe pajisjeve nga ndërrimi në ndërrim. Patrullat kufitare në përfundim të orarit apo ndërrimit patrullues, janë të detyruara që pranim-dorëzimin e detyrave, automjeteve dhe pajisjeve tjera të përbashkëta ta bëjnë në stacione. Kjo metodë aplikohet për shkak të automjeteve dhe pajisjeve të përbashkëta të punës. Procedura e pranim-dorëzimit në ambientet e SPMK-ve krijon mungesë të patrullave kufitare përgjatë vijës patrulluese për një kohë të caktuar, deri sa patrulla pasuese del në detyrë. Kjo metodologji është e rrugës të shqyrtohet që të modifikohet, drejt ofrimit të një shërbimi më cilësor në kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufirit të gjelbër. IPK është e vetëdijshme se kjo formë e pranim-dorëzimit të detyrës nga patrullat policore është e ndikuar nga përdorimi i përbashkët i pajisjeve,

por duhet gjetur modalitete drejt ngritjes së sigurisë në kontrollin e kufirit dhe ndërprerjes së rrugëve të krimit ndërkufitar.


3.3.3. Mbikëqyrja e kufirit nga SPMK-të kryhet me qëllim të parandalimit të kalimeve të pa autorizuara të kufirit, luftimit të krimit ndërkufitar dhe aplikimit të masave ligjore ndaj personave të cilët tentojnë të kalojnë kufirin ilegalisht. Mbikëqyrja e kufirit kryhet me ekipe patrulluese statike dhe mobile nëpërmjet patrullimeve ose vendosjes në vendet që konsiderohen pika të nxehta. Ekipet patrulluese praktikojnë patrullime në këmbë, patrullime me automjete, patrullime të kombinuara, vëzhgime të fshehta, prita policore dhe pika kontrolli. IPK-ja ka kryer një krahasim të aktiviteteve patrulluese të SPMK-ve në kuadër të tre DRPK-ve dhe të dhënat e prezantuara përfaqësojnë vetëm aktivitetet e SPMK-ve përgjatë vijës patrulluese kufitare. Përgjithësisht, ‘Veriu’ dallon më shumë nga DRPK-të tjera me metodën e aplikimit të patrullimeve me automjet, ‘Lindja’ me aplikimin e pikave të kontrollit, kurse ‘Perëndimi’ me patrullimet në këmbë. Indikatorët e performances tregojnë se viti 2015 e 2016 janë shquar me numër më të madh të patrullimeve me automjet dhe patrullimeve në këmbë, kurse viti 2016 me numër më të madh të pikave të kontrollit. Patrullimet me automjet në dy vitet e fundit kanë shënuar rënie në krahasim me vitin 2015, siç kanë shënuar edhe patrullimet në këmbë, kurse viti 2016 ka qenë më i dalluar sa i përket pikave të kontrollit. Në rast se ka rënë numri i patrullimeve me automjet për shkak të gjendjes së rëndë me automjete, duhet të dihet pse në ndërkohë ka rënë edhe numri i patrullimeve në këmbë. Duhet analizuar këta indikatorë në mënyrë që të ngriten indikatorët, duke ngritur edhe sigurinë në kufirin shtetëror dhe duke zvogëluar në kontinuitet krimin ndërkufitar.

Tabela nr. 7 - Të dhëna përmbledhëse mbi aktivitetet patrulluese të SPMK-ve (2015-2017)									
DRPK	Patrullime me automjet			Patrullime në këmbë			Pika të kontrollit		
	2015	2016	2017	2015	2016	2017	2015	2016	2017
Veriu	5.544	5.141	5.027	2.174	2.126	2.009	2.005	1.979	2.219
Lindja	5.869	4.171	4.372	4.087	3.923	3.553	7.682	7.325	3.597
Perëndimi	4.589	4.656	4.605	8.671	7.983	8.361	1.724	2.168	1.452
Gjithsej	16.002	13.968	14.004	14.932	14.032	13.923	11.411	11.472	7.268

3.3.4. Nga të dhënat e siguruar nga DRPK-të dhe SPMK-të, IPK ka nxjerrë disa indikatorë për të pasqyruar performancën e SPMK-ve në kontrollin dhe mbikëqyrjen e vijës së gjelbër. IPK-ja ka nxjerrë disa indikatorë mbi aktivitetet patrulluese në nivel të DRPK-ve, SPMK-ve dhe ndërrimeve ditore. Në vitin 2017, DRPK-të mesatarisht kanë kryer 12.8 patrullime me automjet gjatë një dite, që rezulton me 3.2 patrullime të kryera nga një SPMK gjatë një dite apo 1.6 patrullime të realizuara me automjet brenda një ndërrimi. DRPK-të mesatarisht kanë kryer 12.7 patrullime në këmbë gjatë një dite, që rezulton me 3.2 patrullime të kryera në këmbë nga një SPMK gjatë një dite apo 1.6 patrullime të realizuara në këmbë brenda ndërrimit. DRPK-të mesatarisht kanë realizuar 6.8 pika të kontrollit gjatë një dite, që rezulton me 1.7 pika kontrollit të realizuara nga një SPMK gjatë një dite apo 0.9 pika të kontrollit të realizuara brenda ndërrimi. DRPK-të ‘Veriu’ dhe ‘Lindja’ duhet të analizojnë numrin e patrullimeve në këmbë, derisa DRPK-të ‘Veriu’ dhe ‘Perëndimi’ duhet të analizojnë numrin e pikave të kontrollit. Krahasimet dhe analizat e tilla do të ndihmojnë Policinë për të përmirësuar performancën dhe për të ngritur indikatorët mbi metodologjinë e përdorur në aktivitetet patrulluese.

Tabela nr. 8 - Të dhëna përmbledhëse mbi aktivitetet ditore patrulluese të SPMK-ve (2017)									
DRPK	Patrullime ditore me automjetet			Patrullime ditore në këmbë			Pika të kontrollit në ditë		
	Në nivel të DRPK	Në nivel të SPMK	Në nivel ndërrimi	Në nivel të DRPK	Në nivel të SPMK	Në nivel ndërrimi	Në nivel të DRPK	Në nivel të SPMK	Në nivel ndërrimi
DRPK 'Veriu'	13.8	3.45	1.7	5.5	1.4	0.7	6.4	1.5	0.8
DRPK 'Lindja'	12.0	3.0	1.5	9.7	2.4	1.2	9.9	2.5	1.3
DRPK 'Perëndimi'	12.6	3.15	1.6	22.9	5.7	2.9	4	1	0.5
Gjithsej	12.8	3.2	1.6	12.7	3.2	1.6	6.8	1.7	0.9

3.3.5. Policia Kufitare me qëllim të luftimit të krimit ndërkufitar kryen kontrole mbi ligjshmërinë e hyrje-daljeve të personave, gjësendeve, automjeteve dhe bagazheve. Pjesa më e madhe e këtyre kontroleve kryhen në vijën e parë të kontrollit dhe në situata të dyshimta edhe në vijën e dytë të kontrollit. Në vijën e parë të kontrollit në hyrje-dalje, IPK-ja ka kryer një inspektim të rastit dhe ka vlerësuar se veprimet e Policisë Kufitare janë ndërmarrë në harmoni me PSO-në mbi Standardet e Kontrollit Kufitar. IPK-ja çmon angazhimet dhe përkushtimin në respektimin e procedurave dhe rregullave të kontrollit konform PSO-së për Standardet e Kontrollit Kufitar. Të dhënat tregojnë se kontrollet në hyrje/dalje në nivel vendi për persona dhe automjete në tre vitet e fundit kanë shënuar ngritje të dukshme. Numri i personave të kontrolluar në vitin 2016 është ngritur për 8% krahasuar me vitin 2015, kurse numri i veturave ka shënuar ngritje për 8.7%. Ngritja ka vazhduar edhe në vitin 2017 në të dy kategoritë. Numri i personave të kontrolluar në vitin 2017 ka shënuar ngritje për 3.7%, kurse numri i veturave për 12.6% në krahasim me vitin 2016. Sipas të dhënave kemi edhe ngritje të numrit të kontroleve të vijës së dytë. Në vitin 2015 janë regjistruar gjithsej 40.752 kontrole të personave, kurse në vitin 2016 kjo shifër arrinë në 50.981 dhe në vitin e fundit në 57.169. Shifrat në ngritje tregojnë se kemi rritje të kontrollit të vijës së dytë nga viti në vit. IPK-ja vlerëson këto aktivitete dhe inkurajon Policinë Kufitare që të vazhdojë më tutje me këto aktivitete me qëllim të lehtësimit të lëvizjes së njerëzve, automjeteve dhe mallrave, si dhe parandalimit dhe luftimit të krimit ndërkufitar.



3.3.6. IPK-ja ka inspektuar SPK-të në PKK-të e kategorisë A, ka analizuar e krahasuar indikatorët e performances së tyre. Vërmica mbetet stacioni më i frekuentuar që përfaqësohet me 34% apo 1/3 e të gjitha kontrolleve të personave në nivel vendi, pasuar nga Hani i Elezit me 15%. Të gjitha stacionet e kategorisë A, në përjashtim të atij të Jarinjës, kanë shënuar rritje të numrit të personave të kontrolluar. IPK-ja ka qenë e fokusuar në performancën e SPK-ve të kategorisë A, të cilat viteve të fundit ballafaqohen me fluks më të madh të personave dhe automjeteve. Referuar në tabelën e prezantuar ku pasqyrohen disa indikatorë të performancës, del që mesatarisht brenda një minute në të gjitha pikat e kalimit kufitar të vendit kontrollohen 32 persona, prej të cilëve, 25 sish kontrollohen në stacionet e kategorisë A. Vërmica frekuentohet mesatarisht nga 10 persona në minutë, pasuar nga Hani i Elezit me 4 persona, Dheu i Bardhë dhe Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës me nga 3 persona. Sa i përket ngarkesës për polic, një polic i Vërmicës kontrollon mesatarisht 90.009 persona në vit, pasuar nga Hani i Elezit me 36.276 persona dhe Dheu i Bardhë me 35.580 persona. Kulla shënon numër më të vogël të personave të kontrolluar nga të gjitha stacionet e kategorisë A. Kulla dallon edhe për numër më të ulët të personave të kontrolluar në një minutë dhe për nga numri i personave të kontrolluar në vit për polic. Bazuar në këta indikatorë, polici i angazhuar në kontrollin kufitar të Vërmicës ka ngarkesë më të madhe të punës se cilido polic tjetër i angazhuar në cilindo stacion tjetër kufitar. Apo edhe e kundërta, polici i Kullës ka ngarkesë më të vogël të punës se cilido polic tjetër i angazhuar në cilindo stacion tjetër kufitar. Analizat e tilla mund t'i ndihmojnë menaxhmentit të lartë policor për të vlerësuar angazhimet dhe burimet e nevojshme për kryerjen e aktiviteteve policore në kontrollet kufitare në SPK/PKK.

SPK	Indikatorët e performances			
	Numri i policëve	Numri i personave të kontrolluar në vit	Numri i personave të kontrolluar në minutë	Numri i personave të kontrolluar për polic në vit
Jarinje	43	1.179.919	2	27.440
Merdare	48	1.046.303	2	21.798
Hani i Elezit	56	2.212.828	4	36.276
Dheu i Bardhë	45	1.423.215	3	35.580
Vërmicë	61	5.490.577	10	90.009
Kullë	31	427.849	1	13.802
ANP	82	1.738.461	3	21.213

3.3.7. Plani Zhvillimor Strategjik i PK-së 2016-2020 ka vënë objektiv strategjik, 'zbatimin e kontrollit dhe mbikëqyrjes së kufirit në përputhje me standardet e Schengenit'. PK-ja ka përcaktuar edhe aktivitetin për përmbushjen e aktivitetit të tillë që është 'rritja e efikasitetit në kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufirit në parandalimin dhe luftimin e krimit ndërkufitar dhe migrimit të pa rregullt'. Të drejtat dhe detyrimet e të huajve në Republikën e Kosovës, hyrja, qëndrimi, qarkullimi dhe punësimi i shtetasve të huaj brenda territorit tonë rregullohen me dispozitat ligjore që burojnë nga Ligji për të Huajt dhe akteve tjera që burojnë nga ky ligj. Shtetasit e huaj obligohen që gjatë lëvizjes dhe qëndrimit në vendin tonë t'i përmbahen ligjit të zbatueshëm. Rol të rëndësishëm për kontrollin e migracionit luan Drejtoria për Migrim dhe të Huaj në kuadër të Divizionit për Menaxhim të Integruar të Kufirit. Kjo obligohet të bashkëpunojë me agjenci dhe institucione tjera relevante të zbatimit të ligjit në trajtimin e migrimit dhe të huajve në vend. Fushëveprimi dhe autorizimet e saj përfshijnë kontrollin e hyrjes, lëvizjes dhe qëndrimit të shtetasve të huaj në territorin e Kosovës. Drejtoria ka kompetencë që të inspektojë bizneset, institucionet apo lokacionet ku dyshohet se ka


imigrant të parregullt, të zbatojë procedura për masat ndëshkimore, mbajtjen, largimin dhe dëbimin e të huajve, të verifikoj shtetasit e huaj që aplikojnë për viza në përfaqësi diplomatike e konsullore, të bëjë trajtimin fillestar të azilkërkesve, të ngrisë performancën në parandalimin e luftimit e imigrimit të p arregullt. Sa i përket shkeljeve që janë identifikuar si më të shpeshta nga shtetasit e huaj në territorin tonë dhe për të cilat janë hapur raste nga Drejtoria për Migrim dhe të Huaj, dallohen ‘qëndrimi në Kosovë në kundërshtim me qëllimin e qëndrimit të përkohshëm’ por që ka trend rënës nga viti në vit dhe ‘mosvazhdimi i lejeqëndrimit të përkohshëm’ që përkundrazi nga e para, ka shënuar ngritje nga viti në vit. Viti 2017 dallon me aktivitete në ngritje të shqiptimit të gjobave dhe inspektiveve të kryera në biznese, institucione dhe lokacione të dyshimta. Viti 2015 shquhet me numrin më të madh të refuzimeve të hyrjeve, refuzimeve të daljeve e deportimeve të ekzekutuara në tre vitet e fundit. IPK-ja çmon aktivitetet e Drejtorisë dhe inkurajon që të vazhdohet tutje në kontrollin e migracionit dhe luftimin e krimit ndërkufitar.

3.4. Performanca policore në hetimin e krimit ndër-kufitar

3.4.1. Në zbatimin e kontrollit e mbikëqyrjes së kufirit në përputhje me standardet e Schengenit, Policia Kufitare synon të rrisë efikasitetin në kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufirit në parandalimin dhe luftimin e krimit ndërkufitar. Këto synime janë të qarta, kur marrim për bazë pozitën gjeo-strategjike të vendit tonë, që paraqet terren të përshtatshëm për krijim të rrugëve të trafiqeve të ndryshme kriminale. Struktura organizative policore, hetimin e krimit ndërkufitar e ka rregulluar të funksionojë në tre nivele: niveli qendror i përfaqësuar nga Sektori i Hetimeve në DPK, niveli rajonal përfaqësuar nga Njësitë e Hetimeve Rajonale dhe niveli lokal të përfaqësuar nga Njësitë e Hetimeve në kuadër të SPK-ve në PKK-të e kategorisë A. Procedurat hetimore që ndiqen në Policinë Kufitare janë të rregulluara me ligjet aplikueshme, aktet e brendshme të Departamentit dhe PSO-në-Sektori i Hetimeve të Departamentit të Policisë Kufitare. Sipas të intervistuarve, kompetenca për trajtimin e rasteve të ngritura respektohet dhe nuk ka ndërhyrje në punët hetimore. Rastet penale dhe kundërvajtjet që ndodhin në PKK dhe vijën e gjelbër/kaltër fillimisht trajtohen nga zyrtarët e Policisë Kufitare, ndërsa për veprimet e më pastajme veprohet varësisht nga rasti i ngritur. Rastet hetohen apo procedohen sipas kompetencës. Njësitë e hetimeve në kuadër të DRPK-ve dhe SPK-ve në PKK merren me raste që procedohen menjëherë dhe nuk ka nevojë për ndërmarje të masave tjera hetimore (kundërvajtjet që lidhen me rendin dhe qetësinë publike). Sektori i Hetimeve në Departamentin për Kufi merret me rastet e kontrabandës me migrant, kalimit të pa autorizuar të kufirit, falsifikimit të dokumenteve, kontrabandimit/posedimit e paligjshëm të armëve dhe të municionit, kontrabandimit apo posedimit e pa ligjshëm të narkotikëve dhe kontrabandimit me vetura/vetura të vjedhura.

3.4.2. Vlerësohet se ka rënie të numrit të veprave penale, duke krahasuar katër vitet e fundit. Në vitin 2015 kanë rënë veprat penale për 13%, duke vazhduar në 2016 për 7% dhe në vitin e fundit për 2%. IPK-ja ka ndarë nga Raporti Vjetor i Punës së Departamentit të Kufirit, informacionin mbi rastet më të shpeshta të ngritura gjatë katër viteve të fundit. Rënie ka shënuar kontrabanda me migrant, kalimi i pa autorizuar i kufirit dhe posedimi i pa ligjshëm i armëve. Kontrabanda me narkotikë, kontrabanda me mallra dhe kontrabanda me kafshë kanë shënuar ngritje. Trend rënës ka edhe numri i arrestimeve për vepra të ndryshme kriminale, i cili është në rënie në tre vitet e fundit. Në vitin 2015 ka pësuar rënie për 7%, në vitin 2016 për 15% dhe në vitin e fundit për 4%. Numri i të arrestuarve me urdhëresa vendore është në ngritje, ku viti i fundit ka rritje të dukshme.

Rënia e veprave penale është rezultat i aktiviteteve pro-aktive dhe reaktive policore në luftën kundër krimit, profesionalizmit, pajisjeve dhe marrëveshjeve me shtetet fqinje për realizimin e patrullimeve të përbashkëta dhe të sinkronizuara. Kundërvajtjet në tre vite kanë shënuar rënie deri në vitin e fundit ku është shënuar ngritje e numrit të kundërvajtjeve. IPK-ja vlerëson punën e Policisë Kufitare dhe inkurajon atë që të vazhdojë me aktivitete pro-aktive dhe reaktive në luftimin e krimit ndërkufitar. Llojet e veprave penale që kanë shënuar ngritje duhet analizuar dhe trajtuar në drejtim të marrjes së masave adekuate drejt goditjes së krimit.



3.4.3. Inspektorët kanë siguruar një numër dosjesh penale si raste të përfunduara në DRPK për vitet 2015 dhe 2016, e gjithë kjo me qëllim për të vlerësuar veprimet hetimore të Policisë Kufitare në trajtimin e rasteve të ngritura në kompetencë. Lidhur me këtë është verifikuar respektimi i ligjit të aplikueshëm në fushën e hetimeve dhe aktet tjera nënligjore, përfshirë dhe PSO-në për Sektorin e Hetimeve të Departamentit të Policisë Kufitare. Nga analiza e dosjeve të siguruar, IPK-ja gjeti se nga 8 (tetë) dosje të kontrolluara, vetëm 2 (dy) prej tyre të Stacionit Policor në ANP kanë shenjat e gishtërinjëve. PSO-ja përcakton që shenjat e gishtërinjëve dhe fotografitë duhet të merren në çdo rast. Nga analiza e dosjeve penale, IPK-ja gjeti se në asnjërën prej tyre nuk kishte Raport policor për Prokurorin e Shtetit. Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Kosovës (neni 70, paragrafi 4), përcakton që ‘posa Policia të ketë dyshim të arsyeshëm se është kryer një vepër penale që ndiqet sipas detyrës zyrtare, është e detyruar që brenda 24 orëve t’i dorëzojë Prokurorit të Shtetit që është kompetent, një raport policor njoftues mbi dyshimin e arsyeshëm se është kryer një vepër penale, i cili më pastaj vendosë nëse duhet filluar procedurë penale. IPK-ja vlerëson punën që kryhet në hetimin e rasteve dhe inkurajon menaxhmentin e Departamentit për Kufi, DRPK-të dhe ANP-në që të shtojnë mbikëqyrjen në drejtim të evitimit të lëshimeve apo mangësive në proces hetimor.

Rekomandimi nr. 7

IPK-ja u rekomandon njësisë hetimore që trajtojnë rastet e ngritura penale që të përkujdesen në evitimin e dobësive apo mangësive të evidentuara gjatë inspektimit lidhur me shenjat e gishtërinjëve dhe raportet njoftuese për Prokurorin e Shtetit, konform Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës, kurse drejtuesve të njësisë hetimore, kujdes të shtuar gjatë mbikëqyrjes së trajtimit të rasteve.

3.5. Evidencat policore dhe sistemi elektronik mbi menaxhimin kufitar

3.5.1. IPK-ja ka vizituar të gjitha SPK-të në PKK-të e kategorisë A dhe nga një SPMK në kuadër të secilës drejtori rajonale. Gjatë inspektimit është parë se në SPK e SPMK mbahen evidenca në përputhje me PSO-në mbi ‘mbajtjen e evidencave’. Stacionet policore kanë orare ditore, plane operative, plane emergjente, evidenca për pajisjet, etj. Policia Kufitare nxjerrë raporte statistikore që janë të standardizuara dhe shërbejnë për hartimin e raporteve periodike ku janë të përfshira të gjitha aktivitetet policore. Lidhur me llojet e evidencave që përcaktohen me PSO, IPK-ja ka verifikuar përdorimin e evidencave të tilla në të gjitha rastet kur përdorimi i tyre është i nevojshëm. IPK-ja ka vlerësuar se nuk janë evidentuar raste kur përdorimi i tyre është anashkaluar. IPK-ja inkurajon Policinë Kufitare në përmbushjen e këtyre rregullave mbi evidencat, ngase kjo i kontribuon lehtësimit, raportimit dhe pasqyrimit të aktiviteteve në ruajtjen dhe kontrollin e kufirit.

3.5.2. IPK-ja gjatë inspektimit dhe intervistave me zyrtarët në Policinë Kufitare gjeti se Sistemi i Menaxhimit të Kufirit (SMK) me gjithë disa probleme harduerike dhe softwerike që e përcjellin, është funksional dhe i mbulon të gjitha PKK-të dhe vijën gjelbër. Në SMK mbahen informata dhe shkëmbehen këto me SIPK-un. SMK është i instaluar në DPK, DRPK, në të gjitha SPK-të dhe disa institucione tjera (Drejtoria për Inteligjencë dhe Analizë, Agjencia e Kosovës për Inteligjencë, Drejtoria Kundër Terrorizmit, Ministria e Punëve të Brendshme, Qendra Kombëtare për Menaxhimin e Kufirit, Drejtoria Kundër Krimin të Organizuar). Qasja në të është e kufizuar në kërkim e verifikim të të dhënave. SMK-ja shfrytëzohet nga Departamenti i Kufirit për të mbledhur e analizuar të dhënat e udhëtimit (pamjet/foto) dhe informatat në hyrje/dalje për secilin person, automjet, dokument udhëtimi dhe krahasohen të dhënat në Stop Listë e më pas lejohet ose nuk lejohet hyrja/dalja.

3.5.3. Sistemi ka rëndësi të veçantë në efikasitetin e sistemit ligjor në përgjithësi në Republikën e Kosovës dhe me gjërë. Qasja për azhurim në Sistem është e ndjeshme për shkak të të dhënave konfidenciale dhe sekrete, andaj i kushtohet vëmendje e veçantë nga menaxhmenti i Departamentit për Kufi. Nivelet e përdorimit të Sistemit janë të ndryshme dhe të kufizuara, sidomos qasja në ndërhyrje-ndryshimin e të dhënave, të cilat bëhen me vendime të organeve kompetente. Ky Sistem ofron mundësi për kontroll në kufi, duke mbledhur të dhëna nga udhëtarët dhe i ruan në bazën e të dhënave. Sistemi mundëson mbledhjen, krahasimin dhe analizimin e të dhënave. Në hyrje/dalje krahasohen informatat e personave, automjeteve dhe dokumenteve me të dhënat në Stop-Listë e më pas lejohet ose jo kalimi. SMK-ja mbështetë regjistrimin e personave, automjeteve në hyrje apo dalje të territorit, ndalimin e personave/veturave/dokumenteve që janë në kërkim, ndalimin e personave të rrezikshëm, identifikimin/verifikimin e personave të zhdukur, auditimin hetimor për të gjitha hyrje/daljet, etj.

3.5.4. Është duke u punuar në integrimin e bazave të të dhënave të sistemeve të autoriteteve të përfshira në menaxhimin e integruar të kufirit, në një bazë të përbashkët të të dhënave. Lidhur me këtë, është hasur në pajtueshmëri nga akterët e përfshirë në MIK dhe është konstatuar fizibiliteti i projektit nga ekspertë të fushës përkatëse. Momentalisht ky projekt është duke u trajtuar përbrenda procedurave të prokurimit dhe pritet që këtë vit të finalizohet. Vlerësohet se baza e përbashkët e të dhënave do të mund t’i kontribuoj ngritjes së performancës policore në kryerjen e detyrave rreth menaxhimit të kontrollit dhe ruajtjes së kufirit.

3.6. Kushtet teknike dhe të sigurisë

3.6.1. Kryerja e aktiviteteve në ruajtjen dhe kontrollin e kufirit këkon edhe kushte fizike, teknike dhe të sigurisë. Plani Zhvillimor Strategjik ka përcaktuar krijimin e kushteve për qarkullim të lirë të njerëzve dhe mallrave në kufi. Në mesin e aktiviteteve që janë përcaktuar të ndërmerren për këtë periudhë është ndërtimi dhe modernizimi i infrastrukturës dhe objekteve në PKK sipas standardeve ndërkombëtare. IPK-ja ka parë për së afërmi infrastrukturën fizike, teknike dhe të sigurisë së Departamentit të Kufirit dhe DRPK-ve. Selitë e Departamentit të Kufirit dhe DRPK-ve janë të vendosura në objekte me ndërtim të fortë. ‘Lindja’ e ‘Perëndimi’ janë të vendosura në objektet e stacioneve policore të rendit (Gjakovë e Kaçanik), ndërsa ‘Veriu’ ka objektin e vet. Kushtet e punës në Departamentin për Kufi dhe DRPK vlerësohen të mira sa i përket hapësirës, ndriçimit, monitorimit, parkingjeve, me përjashtim të ‘Perëndimit’, ku hapësira është e kufizuar për zyrtarët dhe e ndarë në dy objekte. Një pjesë e personelit është sistemuar në objektin e DRP-Gjakovës dhe një pjesë tjetër në kontejner brenda oborrit të DRP-së së Gjakovës. Në Gjakovë është në proces ndërtimi i objektit të ri ku do të vendoset DRPK ‘Perëndimi’. IPK-ja gjeti se mirëmbajtja dhe pastërtia në objektet e inspektuara ishte e mirë.

3.6.2. IPK-ja ka inspektuar SPK-të në PKK-të të kategorisë A dhe ka parë se PKK-të e kategorisë A me Serbinë (Dheu i Bardhë, Jarinje dhe Merdare) dhe Malin e Zi (Kulla) janë të vendosura në objekte të përkohshme (kontejner). Objekti i përbashkët në mes të Kosovës e Serbisë në PKK në Merdare është në proces të ndërtimit. PKK tek Dheu i Bardhë dhe në Jarinje, në bazë të protokollit teknik për MIK-un, të nënshkruar në Bruksel në mes të Kosovës dhe Serbisë janë në territorin e Serbisë, ndërsa PKK në Merdare në territorin e Kosovës. Ndërsa, objektet ku janë të vendosura SPK-të në PKK të kategorisë A me Shqipërinë (Vërmica) dhe Maqedoninë (Hani i Elezit) janë ndërtim i fortë dhe gjenden në territorin e Kosovës. Sa u përket kushteve fizike dhe hapësirës për aktivitetet policore, për momentin në SPK në PKK me Serbinë janë jo të mira. Në Dhe të Bardhë, Jarinje dhe Merdare nuk kanë qendra të ndalimit, dhoma për dëshmi, dhomë për takime, dhomë për intervista. zyret janë të vogla dhe jo të mjaftueshme, mungon hapësira në bazë të kriterëve për kontroll të vijës së dytë, ndërsa në Merdare për shkak të ndërtimeve në proces, janë improvizuar disa zyre dhe hapësira për kontroll të vijës së dytë. Çështja e infrastrukturës, sigurisë, mirëmbajtjes, pastërtisë në Dhe të Bardhë dhe Jarinje janë në kompetencë të organeve të Serbisë. Ndërsa, në Kullë, kushtet nuk janë të mira, ka hapësirë të pa mjaftueshme, mungon qendra e ndalimit, dhoma e dëshmimeve, salla për takime, dhoma për intervista. Në Vërmicë dhe Han të Elezit, kushtet fizike për aktivitet policor janë të mira, kanë ndriçim brenda/jashtë, qendra ndalimi, dhoma të dëshmimeve, zyre për intervista, sistem funksional të ngrohjes, monitorim të objektit, sistem funksional të alarmit dhe zyre për takime, etj.

3.6.3. Planet emergjente i kanë të gjitha PKK-të me përjashtim të atij në Jarinje. Hidrantet janë të instaluar vetëm në Vërmicë, pajisjet kundër zjarrit janë vendosur në të gjitha objektet e vizituara, me përjashtim të Jarinjes. Pajisjet kundër zjarrit është vlerësuar të jenë me afat të skaduar. Dalje emergjente ka vetëm në objektin e Vërmicës. SPK-të në PKK të kategorisë A kanë të instaluar sistemin e monitorimit në objekte ku janë të vendosura; monitorim në dhomën e dëshmimeve nuk ka në asnjë PKK, sistemi i alarmit në objektet ku janë të vendosura PKK-të ka vetëm në Vërmicë dhe Han të Elezit, alarm në dhomën e dëshmimeve ka në Vërmicë. Sa i përket kushteve të ndriçimit e pastërtisë, ato janë të mira në të gjitha PKK-të e kategorisë A. Në vitin 2016 është instaluar sistemi

i kamerave CCTV dhe ANPR dhe se ky proces do të vazhdojë edhe në të ardhmen me qëllim të përfshirjes në këtë sistem të të gjitha PKK-ve. Policia Kufitare fillimisht ka bërë instalimin e këtij sistemi në SPK në Han të Elezit, Merdarë, Vërmicë, Jarinjë, Kullë, Dheu i Bardhë. Ndërsa, në SPK në Vërmicë, Kullë, Hani i Elezit dhe Gllaboqicë është instaluar sistemi i kamerave ANPR (lexuesi automatik i targave të automjeteve). IPK-ja vlerëson se infrastruktura në këto PKK në përgjithësi është e pranueshme për ushtrimin e kontrollit kufitar dhe inkurajon menaxhmentin të punojë në vazhdimësi në përmirësimin e infrastrukturës.

3.6.4. SPMK në Keqekollë është në objekt me ndërtim të fortë me hapësira të mjaftueshme, por objekti është i vjetër dhe ka mungesë dritaresh, dyerve, rrethojës, ndriqimit dhe nuk ka monitorim me kamerë. Gjendja e pastërtisë në objekt ishte e mirë. SPMK në Vitomiricë është e vendosur në objektin e policisë së rendit dhe nuk ka hapësirë të mjaftueshme, ngase një pjesë e stafit punon në kontejner dhe me vështirësi kryhen aktivitetet policore kufitare nga stafi i stacionit. Ndriqimi dhe rrethoja është jo e mirë. Gjendja e pastërtisë në objekt vlerësohet e mirë. SPMK në Gjilan është e vendosur në objekt të përkohshëm në kontejner. Në SPMK nuk ka hapësirë të mjaftueshme dhe me vështirësi kryhen aktivitetet nga stafi. Ndriqimi është i dobët kurse gjendja e pastërtisë në objekt ishte e mirë.

Rekomandimi nr. 8

IPK-ja i rekomandon menaxhmentit të Departamentit për Kufi që të kujdeset në përmirësimin e kushteve infrastrukturore dhe të sigurisë në objektet policore ku zhvillojnë aktivitetet DRPK-të, SPK-të dhe SPMK-të, duke shtuar përpjekjet për një punë cilësore dhe efikase të personelit në raport me standardet e kërkuara.

4. Plani i përmbushjes së rekomandimeve

4.1. Plani për përmbushjen e rekomandimeve

4.1.1. Mbi bazën e gjetjeve, IPK-ja ka dhënë një numër rekomandimesh dhe pas komenteve të ofruara nga menaxhmenti policor në takimin përmbyllës të datës 06.02.2018, është vendosur që ato të realizohen sipas Planit të veprimit të prezantuar në tabelën e mëposhtme.

Nr.	Rekomandimi	Niveli i prioritetit	Komentet e strukturës policore	Plani i veprimit
1.	IPK-ja u rekomandon Departamentit të Kufirit që në bashkëpunim me Divizionin e Burimeve Njerëzore të bëjnë një analizë të nevojave për burimet njerëzore dhe të ndërmarrin hapa konkret drejt vendosjes së tyre varësisht nga numri dhe gradat, të përcaktuar me Listën e Autorizuar të Personelit.	(I)	Rekomandimi është i qëndrueshëm dhe do të zbatohet nga ana e Departamentit për Kufi në bashkëpunim me Departamentin për Burime Njerëzore. Vitin e kaluar është krijuar një grup punues në nivel të Policisë së Kosovës, ku edhe Departamenti për Kufi është i përfaqësuar në vlerësimin e nevojave për personel, në kuantitete dhe kualitete	Gjatë vitit 2018
2.	IPK-ja i rekomandon Departamenti të Kufirit që të analizojë gjendjen aktuale dhe të shqyrtojë fuqizimin e mekanizmit për lëvizjen e personelit, përfshirë edhe atë të graduar në kuadër të strukturës policore të kufirit, duke marrë parasysh faktorët ndikues, por gjithnjë duke vlerësuar se kjo mund t'i shërbejë shëndetit të organizatës dhe ngritjes së efikasitetit brenda shërbimit.	(I)	Rekomandimi është i qëndrueshëm dhe do të zbatohet nga ana e Departamentit për Kufi. Do të ketë vështitësi në zbatimin e këtij rekomandimi, për shkak të mungesës së kapaciteteve në realizimin në tërësi të këtij rekomandimi.	Viti 2020
3.	IPK-ja i rekomandon Departamentit të Kufirit që në të ardhmen të ndërmarrë veprimet e nevojshme që konform Rregullores për Personel dhe Administratë, si dhe Procedurës Standarde të Operimit për rregullat dhe procedurat e trajnimeve dhe studimeve në Fakultetin e Sigurisë Publike, të përfshijë personelin policor në trajnimet e nevojshme, përfshirë ato të	(I)	Rekomandimi është i qëndrueshëm dhe do të realizohet nga Departamenti për Kufi në bashkëpunim me Departamentin për Burime Njerëzore, dhe Departamentin për Shërbime Mbështetëse.	Rekomandimi do të realizohet gjatë vitit 2019, për të gjitha trajnimet e brendshme dhe ricertifikuese, ndërsa për studime në Fakultetin e Sigurisë Publike, do të varet nga

	<i>brendshme, trajnimet ricerfitikuese dhe trajnimet tjera të nevojshme për Policinë Kufitare.</i>			<i>kapacitetet e Fakultetit, si dhe interesimi i shprehur brenda PK-së</i>
4.	<i>IPK-ja i rekomandon Departamentit të Kufirit, që varësisht nga mundësitë buxhetore për avancimin e infrastrukturës teknike në fushën e menaxhimit të ruajtjes dhe kontrollit të kufirit, të pajisë të gjitha stacionet policore kufitare me pajisjet e nevojshme të kontrollit kufitar, siç përcaktohet me PSO-në mbi Standardet e Kontrollit Kufitar.</i>	(I)	<i>Rekomandimi është i qëndrueshëm dhe do të realizohet nga Departamenti për Kufi, në bashkëpunim me Departamentin për Shërbime Mbështetëse, si dhe agjencitë e huaja, të cilat na mbështesin me pajisje. Është një proces në vazhdimësi i avancimit në pajisje dhe teknologji në kontrollin kufitar.</i>	<i>Gjatë vitit 2018 si dhe viteve në vazhdim.</i>
5.	<i>IPK-ja i rekomandon Departamentit të Kufirit që të sanojë problemet teknike që krijojnë pengesa në kryerjen e kontroleve dhe regjistrimeve të nevojshme në Sistemin e Menaxhimit Kufitar (SMK) dhe po ashtu të ndërmarrë hapat e nevojshëm në bashkëpunim me DTIK-un dhe njësitë tjera policore në përditësimin e informatave në Stop-Listë në kuadër të SMK-së.</i>	(I)	<i>Rekomandimi është i qëndrueshëm dhe do të realizohet nga Departamenti për Kufi në bashkëpunim edhe me agjencitë tjera (DTIK, Gjyqësorin, Prokurorinë, etj)</i>	<i>Ky rekomandim do të realizohet gjatë vitit 2018, në vazhdimësi edhe gjatë viteve në vijim, pasi që do të varet edhe nga veprimi i agjencive tjera, me kërkesën e të cilave, personat janë vendosur në Stop-Listë.</i>
6.	<i>IPK-ja u rekomandon Drejtorit të Departamentit të Shërbimeve Mbështetëse dhe Drejtorit të Departamentit të Kufirit, që të ndërmarrin veprimet e nevojshme në sanimin e gjendjes së rëndë me automjete, në mënyrë që të eliminohen situatat që mund të ndikojnë në rënien e efektivitetit dhe të performancës së njësive policore kufitare.</i>	(I)	<i>Rekomandimi është i qëndrueshëm. Departamenti për Kufi në vazhdimësi ka bërë vlerësimin e nevojave për automjete, tek Departamenti për Shërbime Mbështetëse, të cilat nuk kanë mundur të realizohen në vitet e mëparshme. Ky është një problem, i cili po e përcjell Departamentin në vazhdimësi, dhe po reflektohet në kontrollin kufitar si dhe sigurinë kufitare.</i>	<i>Për realizimin e këtij rekomandimi do të jetë vështirë të përcaktojmë afate kohore.</i>
7.	<i>IPK-ja u rekomandon njësive hetimore që trajtojnë rastet e ngritura penale që të përkujdesen në evitimin e dobësive apo mangësive të</i>	(I)	<i>Rekomandimi është i qëndrueshëm. Departamenti për Kufi do ta realizojë këtë rekomandim.</i>	<i>Shtator 2018</i>

	<i>evidentuara gjatë inspektimit lidhur me shenjat e gishtërinjëve dhe raportet njoftuese për Prokurorin e Shtetit, konform Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës, kurse drejtuesve të njësisë hetimore, kujdes të shtuar gjatë mbikëqyrjes së trajtimit të rasteve.</i>			
8.	<i>IPK-ja i rekomandon menaxhmentit të Departamentit për Kufi që të kujdeset në përmirësimin e kushteve infrastrukturore dhe të sigurisë në objektet policore ku zhvillojnë aktivitetet DRPK-të, SPK-të dhe SPMK-të, duke shtuar përpjekjet për një punë cilësore dhe efektive të personelit në raport me standardet e kërkuara.</i>	<i>(1)</i>	<i>Rekomandimi është i qëndrueshëm. Departamenti për Kufi në bashkëpunim me Departamentin e Shërbimeve Mbështetëse do të punojë në përmirësimin e infrastrukturës, me të cilën do të ngritet edhe kualiteti i sigurisë në objektet policore kufitare.</i>	<i>Viti 2020</i>

Shtojcat

Shtojca 1. Të dhëna mbi nivelin e përmbushjes së rekomandimeve nga inspektimi i kaluar				
Nr.	Gjetjet nga inspektimi i mëparshëm (viti 2012) Inspektimi: Menaxhimi i Policisë Kufitare, nr. 8/2012			Niveli i zbatimit po/jo
	Rekomandimi i dhënë	Komentet e strukturës policore	Afatet për zbatim	
1.	<i>IPK-ja i rekomandon Drejtorit të Departamentit të Policisë Kufitare që shpërndarja e personelit të behet në pajtim me strukturën organizative në fuqi. Të plotësohen nevojat për personelin menaxhues të vijës së parë dhe të mesme si dhe në kuadër të strukturës organizative, të evitohen shkëputjet e zinxhirit vertikal të gradës.</i>			Vlerësimi nga IPK-ja: <i>Përgjithësisht është realizuar</i>
2.	<i>IPK-ja i rekomandon Drejtorit të Departamentit të Policisë Kufitare që të vendosë standarde konkrete të raportimit për të gjitha nivelet e organizimit në kuadër të Policisë Kufitare, të cilat do të pasqyrojnë saktësisht natyrën dhe ngarkesën konkrete të punës, konform detyrave dhe përgjegjësi të tyre.</i>			Vlerësimi nga IPK-ja: <i>Plotësisht është realizuar</i>
3.	<i>IPK-ja i rekomandon Drejtorit të Departamentit të Policisë Kufitare që sa më shpejt të reagojë në përmbushjen e obligimit nga PSO-ja për Ushtrimin e Policimit në Kontrollin dhe Mbikëqyrjen e Kufirit (DA/DPK-002/09) që një tog patrullues të mos ketë më shumë se 20-30 km nën mbikëqyrje.</i>			Vlerësimi nga IPK-ja: <i>Rekomandim i pa vlerësuar</i>
4.	<i>IPK-ja i rekomandon, Drejtorit të Departamentit të Policisë Kufitare që të mos toleroj standarde të ndryshme të raportimit nga njësi organizative që kanë detyra dhe përgjegjësi të njëjta.</i>			Vlerësimi nga IPK-ja: <i>Plotësisht është realizuar</i>
5.	<i>IPK-ja i rekomandon Drejtorit të Departamentit të Policisë Kufitare që sa më shpejt të zhvillojë inspektime të njëjësive të saj lidhur me respektimin e PSO-ve për përdorimin, ruajtjen e mirëmbajtjen e armëve dhe të përmirësimit gjendjen aktuale.</i>			Vlerësimi nga IPK-ja: <i>Plotësisht është realizuar</i>
6.	<i>IPK-ja i rekomandon Drejtorit të Departamentit të Policisë Kufitare që sa më shpejt të angazhohet me seriozitetin më të madh në respektimin e PSO-Menaxhimi i Njësisive Patrulluese (KDSP/018/11) në kapitullin 3.3 në pikën 4 dhe 5, i cili obligon, udhëheqësit e sektorëve, mbajtjen e takimeve të ndërsjella me komunitetin, me qëllim të orientimit të bashkëveprimit dhe bashkëpunimit të ngushtë mes përgjegjësit të sektorit dhe organeve të qeverisjes lokale, KKSB, EVSB, KLSP-së dhe</i>			Vlerësimi nga IPK-ja: <i>Plotësisht është realizuar</i>

	<i>shoqërisë civile dhe që këto aktivitete të përcillen me procesverbale zyrtare.</i>			
7.	<i>IPK-ja i rekomandon Drejtorit të Departamentit të Policisë Kufitare që të organizojë inspektime të shpeshta të aktiviteteve operative dhe të shfrytëzimit të pajisjeve operative të zyrtarëve policorë kufitar në terren, në mënyrë që të ngritet performanca dhe përkushtimi i zyrtarëve policorë kufitar dhe i mbikëqyrësve të tyre.</i>			Vlerësimi nga IPK-ja: <i>Plotësisht është realizuar</i>
8.	<i>IPK-ja i rekomandon Drejtorit të Departamentit të Policisë Kufitare që në standardet e raportimit të paraqiten edhe statistikat e kontrollimit të vijës së dytë nga Pikë Kalimet Kufitare.</i>			Vlerësimi nga IPK-ja: <i>Plotësisht është realizuar</i>
9.	<i>IPK-ja i rekomandon Drejtorit të Departamentit të Policisë Kufitare që sa më shpejt të angazhohet me seriozitetin më të madh në hartimin e një plani konkret për kapërcimin e gjendjes aktuale në trajnimet dhe ri-certifikimet e Policisë Kufitare, ku duhet të përcaktohet një afat sa më i shkurtër i mundshëm ku të gjithë zyrtarët policorë të Policisë Kufitare të kenë të gjitha trajnimet e obligueshme, të kryera ashtu siç janë të përcaktuara me procedurat në fuqi.</i>			Vlerësimi nga IPK-ja: <i>Pjesërisht është realizuar</i>
10.	<i>IPK-ja i rekomandon Drejtorit të Departamentit të Policisë Kufitare që të angazhohet në përpilimin e një programi trajnimi për Policinë Kufitare, në forme pakoje trajnimi për nivelin e mesëm dhe të lartë menaxherial, i cili do të përmbledhte llojllojshmërinë e trajnimeve, të cilat tani ofrohen ndarazi dhe i cili do të ishte obligativ për pozitat në nivelin e mesëm dhe të lartë menaxherial në kuadër të Policisë Kufitare.</i>			Vlerësimi nga IPK-ja: <i>Plotësisht është realizuar</i>
11.	<i>IPK-ja i rekomandon Drejtorit të Departamentit të Policisë Kufitare që sa më shpejt të fillojë procesin e përshkrimit të punës për secilën pozitë në kuadër të Departamentit të Policisë Kufitare.</i>			Vlerësimi nga IPK-ja: <i>Plotësisht është realizuar</i>
12.	<i>IPK-ja i rekomandon Drejtorit të Departamentit të Policisë Kufitare që të angazhohet në respektimin e Ligjit nr. 03/L-038 për Përdorimin e Simboleve Shtetërore, neni 7 pika 6, që thotë: “Ndalohet vendosja publike e flamujve shtetërorë nëse janë të vjetëruar apo dëmtuar” (sidomos në Gllloboçicë, Hani i Elezit, Mutivodë, Merdarë dhe NJPK në Zhur) dhe në vendosjen shenjzimeve të nevojshme paralajmëruese në zonat kufitare.</i>			Vlerësimi nga IPK-ja: <i>Përgjithësisht është realizuar</i>